

ANKETË E UDHËHEQUR NGA OSBE PËR DHUNËN NDAJ GRAVE NË SHQIPËRI

MIRËQENIA DHE SIGURIA E GRAVE

SHQIPËRI
RAPORTI I REZULTATEVE



This project is funded
by the European Union



Ständige Vertretung
der Bundesrepublik Deutschland bei der OSZE:
Wien



Norwegian Ministry
of Foreign Affairs



EUROPE
INTEGRATION
FOREIGN AFFAIRS
FEDERAL MINISTRY
REPUBLIC OF AUSTRIA



Ministry for Foreign
Affairs of Finland



www.osce.org

ISBN 978-3-903128-42-2

Kjo anketë është kryer në përputhje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të cilësisë për Studimin e Tregut, ISO 20252: 2012, si dhe me Termat dhe Kushtet Ipsos MORI, të cilat mund të gjenden në <http://www.ipsos-mori.com/terms>.

© OSCE 2019

OSBE-ja ka treguar kujdes të nivelit më të lartë në hartimin e materialeve të këtij botimi. Megjithatë, OSBE-ja nuk mban asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacionit, udhëzimeve dhe këshillave të ofruara dhe as për gabimet e shtypshkrimit. Përmbajtja e këtij botimi, pikëpamjet, opinionet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura këtu u përkasin autorëve dhe atyre që ndihmuan në realizimin e tij dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën apo qëndrimin zyrtar të OSBE-së dhe Shteteve pjesëmarrëse të saj.

Të gjitha fotot e përdorura në këtë botim janë marrë nga arkivat.

ANKETË E UDHËHEQUR NGA OSBE PËR DHUNËN NDAJ GRAVE NË SHQIPËRI

MIRËQENIA DHE SIGURIA E GRAVE

SHQIPËRI
RAPORTI I REZULTATEVE



Organization for Security and
Co-operation in Europe

Vështrim i përgjithshëm

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), organizata më e madhe e sigurisë rajonale në botë, trajton një spektër të gjerë sfidash që lidhen me sigurinë, përfshirë mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimin e barazisë gjinore. Ndër fushat kryesore të veprimtarisë së organizatës janë nxitja e bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë, si dhe parandalimi i konflikteve, menaxhimi i krizave dhe situatave pas konfliktit. OSBE përbëhet nga 57 shtete pjesëmarrëse me shtrirje në të gjithë Evropën dhe me përfshirjen e Shteteve të Bashkuara, Kanadasë, Azisë qendrore, si dhe Mongolisë. Falë punës së Sekretariatit, tre institucioneve të specializuara dhe 16 operacioneve në terren, OSBE trajton sfida të shumta në fushën e sigurisë duke ndihmuar shtetet pjesëmarrëse të zbatojnë angazhimet e tyre politike të gjithanshme.

OSBE-ja e konsideron dhunën ndaj grave dhe vajzave¹ njëherazi kërcënim për individët dhe, në një kuadër më të gjerë, edhe çështje sigurie. Për rrjedhojë, ajo e sheh parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave si një nga prioritetet e saj. Dhuna ndaj grave dhe vajzave është një shkelje e vazhdueshme e të drejtave të njeriut që kërcënon sigurinë dhe jetën e shumë grave dhe vajzave në mbarë botën. Kjo dhunë jo vetëm ndikon në jetën e tyre, duke i penguar të marrin pjesë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë në shoqëri, por prek edhe të afërmit e tyre. Së fundi, dhuna ka një ndikim të fuqishëm dhe afatgjatë në shëndetin dhe mirëqenien e grave, tek fëmijët e tyre, komunitetet dhe shoqërinë në përgjithësi.

Në themel të dhunës ndaj grave dhe vajzave qëndron pabarazia gjinore. OSBE-ja luan një rol kyç me palët e interesit duke punuar për ndërtimin e kapaciteteve të tyre për parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtjen e të mbijetuarave.² Nën moton “Ndërgjegjësim për sigurinë”, OSBE-ja nënvizon faktin se gratë dhe vajzat duhet të jenë të sigurt si në mjediset publike, ashtu edhe në shtëpi, në mënyrë që ato të jenë në gjendje të përdorin gjithë potencialin e tyre dhe të japin ndihmesën e tyre në zhvillimin politik, ekonomik dhe shoqëror.

Dhuna ndaj grave dhe vajzave është një dukuri që shoqëron edhe luftërat, çka shërbeu si shtysë që OSBE-ja të ndërmarrë këtë studim cilësor dhe sasior për të hedhur dritë mbi përhapjen e formave të ndryshme të dhunës ndaj grave dhe vajzave, në kushtet si të konfliktit ashtu edhe të paqes, në disa nga shtetet pjesëmarrëse të saj, si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Moldavia dhe Ukraina. Studimi u shtri edhe në Kosovë.³

Ky studim, që është edhe anketa e parë përfaqësuese e këtij lloji në Evropën juglindore, ose në Evropën lindore, dhe që ofron të dhëna të krahasueshme për të gjithë rajonin, ngërthen gjithashtu qëndrimet gjinore dhe përvojat e grave që u përkasin pakicave.⁴ Qëllimi i tij është të sigurojë të dhëna të besueshme për hartimin e politikave, strategjive, programeve dhe aktiviteteve sa më gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në fakte e shifra për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave. Qëllimi përfundimtar i këtij studimi është të ofrojë të dhëna për proceset vendimmarrëse dhe fushatat ndërgjegjësuese në të gjitha nivelet, duke kontribuar në këtë mënyrë në realizimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe pakësimin e dhunës ndaj grave në rajonet e përmendur më lart, përmirësimin e shërbimeve për të mbijetuarat e kësaj dhune dhe rritjen e nivelit të sigurisë për gratë.

1 Termat “dhunë ndaj grave” dhe “dhunë ndaj grave dhe vajzave,” të cilat përdoren në vend të njëra-tjetrës në këtë raport, përfshijnë dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike nga partnerët intimë dhe individët jo-partnerë, si dhe përndjekjen dhe ngacmimin seksual të grave dhe vajzave.

2 Në këtë raport termat «të mbijetuarat» dhe «viktimë» janë përdorur në vend të njëra-tjetrës.

3 Të gjitha referencat në lidhje me Kosovën, qoftë për territorin, institucionet apo popullsinë, në këtë tekst duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

4 Pyetësori i përdorur në këtë studim bazohet dhe është i krahasueshëm me pyetësorin e përdorur nga Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore në 28 shtetet anëtare të BE-së në vitin 2012.



Përmbledhje ekzekutive

Hyrje

Ky raport paraqet gjetjet e studimit cilësor dhe sasior të OSBE-së për dhunën ndaj grave në Shqipëri.

Studimi u realizua në pranverë/verë 2018 dhe përfshiu:

- katërmbëdhjetë intervista me ekspertë kyç, të cilat ofrojnë një pasqyrë të çështjeve që lidhen me dhunën ndaj grave si dhe veprimet e dhunshme që burojnë nga konfliktet;
- analizën e një kampioni përfaqësues prej 1,858 grash të moshës 18-74 vjeç që jetojnë në Shqipëri për të përcaktuar shkallën dhe pasojat e dhunës, nëpërmjet një modeli kampionimi me shumë faza, të shtresëzuar dhe me probabilitet rastësor;
- shtatë fokus grupe të përbëra nga gra në kushte të ndryshme, si në zonat rurale, ashtu edhe në ato urbane, ose nga pakicat e ndryshme (rome), me synim studimin e qëndrimeve të tyre kundrejt dhunës ndaj grave;
- katër intervista të thelluara për të studiuar më në hollësi efektet e dhunës së përjetuar nga gratë.

Gjetjet kryesore

Dhuna është shqetësuese për gratë në Shqipëri. Tetëdhjetë e tetë përqind mendojnë se dhuna ndaj grave është një dukuri e zakonshme dhe 53% e tyre mendojnë se kjo dhunë është *shumë* e zakonshme. Tridhjetë e dy përqind e të intervistuarave kishin njohje vetjake në rrethin e tyre familjar ose miqësor, ndërsa 37% e tyre njihnin dikë në lagje që ishte pre e dhunës. Shumë gra të intervistuarave për pjesën sasiore të këtij hulumtimi thanë se kishin dëgjuar për shërbime që ofrohen në ndihmë të grave të dhunuara; 68% kishin dëgjuar për të paktën një nga organizatat ndihmuese që u përmendën në pyetjet e bëra gjatë intervistës. Megjithatë, shumë pak gra kishin përfituar nga këto shërbime - vetëm 1% e grave të dhunuara fizikisht dhe/ose seksualisht kishin vendosur lidhje me strehëzat apo organizatat në mbështetje të viktimave pas ndonjë incidenti të rëndë.

Njëzet e dy përqind e grave pohuan dhunën fizike dhe/ose seksuale nga partneri apo dikush tjetër që në moshën 15 vjeçare. Ajo që mbizotëronte ishte dhuna e një partneri të mëparshëm: 23% e grave që kishin pasur një partner të mëparshëm që në moshën 15 vjeç kishin qenë viktimë e një ose më shumë formave të dhunës prej tij. Në anën tjetër, 18% e atyre që aktualisht kishin një partner, pohuan se kishin përjetuar dhunë nga partneri intim i tanishëm dhe 11% e grave, në përgjithësi, pohuan se kishin përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga një jo partner. Trembëdhjetë përqind e grave raportuan se ishin përndjekur. Tridhjetë e katër përqind thanë se kishin përjetuar ngacmime seksuale që në moshën 15 vjeçare dhe 17% pohuan se ishin ngacmuar seksualisht në 12 muajt që i paraprinin intervistës.⁵ Gratë në punë të paguara kanë më shumë gjasa të pohojnë se kanë pasur ngacmime seksuale përgjatë jetës (40%) si dhe në 12 muajt përpara intervistës (21%).

Ndikimi i dhunës mund të jetë i rëndë dhe afatgjatë. Më shumë se gjysma e të mbijetuarave deklarorin se vazhdonin të përjetonin zemërim dhe indinjatë, kurse më shumë se një të tretat vazhdonin të ndiheshin të frikësuar. Ato përshkruanin efekte **të tilla** psikologjike si ankth (25%) dhe vështirësi për të fjetur (24%) që vazhdonin t'i mundonin pas episodit më serioz **të dhunës**.

5 Gjithashtu shih një studim të kohëve të fundit nga UN Women: Ngacmimi seksual dhe format e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike urbane në Shqipëri (Tirana: Zyra Kombëtare e UN dhe IDRA Research & Consulting, 2018), përdorur për herë të fundit më 3 shkurt 2019, <http://un.org.al/publications/sexual-harassment-and-other-forms-gender-based-violence-urban-public-spaces-albania>.

Vetëm 3% e grave që kanë përjetuar dhunë nga partneri i tyre i tanishëm kanë raportuar në polici incidentin më të rëndë të dhunës

Dhuna ndaj grave është njëherazi shkak dhe pasojë e pabarazisë gjinore e cila përforcohet nga normat dhe qëndrimet ekzistuese. Gratë e intervistuar në kuadrin e studimit sasiar pohojnë se në Shqipëri zgjedhjet dhe sjelljet e grave ishin të kufizuara, pasi shoqëria pret që ato të vendosin familjen mbi veten e tyre. Dyzet e shtatë përqind e grave të intervistuar mendonin se shumica e shoqeve të tyre janë dakord që “një grua e mirë duhet t’i bindet burrit të saj edhe kur nuk është dakord me të.” Nëntëmbëdhjetë përqind besojnë se pjesa më e madhe e shoqeve të tyre pajtohen me idenë se gruaja e ka për detyrë të kryejë marrëdhënie seksuale me burrin e saj edhe kur nuk ka dëshirë. Por këto mendësi po ndryshojnë.

Në të vërtetë, siç rezultoi nga një numër pohimesh lidhur me qëndrimet e tyre të testuara nga kjo anketë, gratë në moshë më të re, me arsim më të mirë dhe me të ardhura të kënaqshme për momentin, janë dukshëm më pak të prirura të pranojnë konceptet e nënshtrimit të grave ndaj partnerit mashkull. Megjithatë, është e rëndësishme të mbahet parasysh se kjo nuk do të thotë se dhuna në këto grupe nuk ekziston. Për shembull, gratë e moshës 18-39 vjeç kanë më shumë gjasa se sa ato mbi 60 vjeç të pranojnë se kanë përjetuar dhunë nga një jo partner (14% kundrejt 6%), ndërsa gratë me një lloj shkollimi të lartë kanë më shumë gjasa të pranojnë ngacmimet seksuale (60%) krahasuar me gratë që kanë vetëm arsim nëntë vjeçar (18%).

Njëzet e gjashtë përqind e grave, gjithashtu, thanë se kishin qenë pre e dhunës fizike nga një person i rritur që përpara moshës 15 vjeç, duke filluar nga shuplakat deri tek goditjet e rënda, kryesisht nga prindërit, shpesh në më shumë se një rast. Me gjasa kjo ndodh pasi ndëshkimi trupor konsiderohet mënyrë normale për disiplinimin e fëmijëve, nocion ky i rrënjosur thellë në traditë.

Gratë që kanë përjetuar konflikte të armatosura kanë pothuajse dy herë më shumë gjasa t'i jenë nënshtruar dhunës fizike dhe/ose seksuale nga duart e partnerëve të tyre aktualë sesa ato që nuk kanë përjetuar konflikte

Periodha e mungesës së stabilitetit në historinë postkomuniste të Shqipërisë zgjeroi përhapjen e dhunës. Ndonëse të gjitha kishin përjetuar pragun e luftës civile në 1997 dhe 1998, në bazë të anketës rezultoi se një e pesta e grave në Shqipëri ishin ndikuar nga konflikti.⁶ Dyzet e katër përqind e grave thanë se incidenti më i rëndë i dhunës që ato kishin pësuar nga një jo partner përkonte me këtë periudhë, e cila karakterizohej nga pasiguria dhe armatosja në masë e popullsisë. Ky studim, po ashtu, tregon se gratë që u ndikuan nga ngjarjet e viteve 1997-1998, ose konfliktet e tjera në rajon, kanë më shumë gjasa të pohojnë se i janë nënshtruar dhunës së partnerit aktual, p.sh., pothuajse dy herë më shumë gra të ndikuara nga konflikti deklaruan se kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale nga partnerët e tyre të tanishëm në krahasim me ato që nuk u ndikuan nga konflikti (28% kundrejt 15%).

Studimi tregoi se gratë nuk parapëlqejnë t'u drejtohen shërbimeve në rastet kur pësojnë dhunë. Pesëdhjetë e tre përqind e grave të ngacmuara seksualisht nuk kishin folur me askënd për përvojën e tyre; shumica e grave deklaruan se kishin qenë në gjendje ta menaxhonin vetë situatën e tyre. Në rastet kur kishin folur për ngacmimet seksuale që kishin përjetuar, ato rëndom kishin zgjedhur miqtë ose anëtarët e familjes.

Edhe pas incidenteve më serioze të *dhunës fizike dhe/ose seksuale*, 97% e grave që ishin dhunuar nga partneri i tanishëm nuk e kishin raportuar incidentin në polici dhe kjo vlen edhe për 84% të rasteve të dhunës serioze nga partnerët e mëparshëm. Ky fakt mund të shpjegohet me bindjen e 48% të grave se dhuna në familje është “një çështje private” që duhet të mbahet brenda familjes. Sipas statistikave zyrtare të rasteve të raportuara të dhunës në familje për vitin 2017, nga 1,549 raste të raportuara gjithsej, gratë ishin viktimat në 1,109 raste.⁷

Këto qëndrime janë disa nga barrierat që hasin gratë për të kërkuar ndihmën e shërbimeve përkatëse. Disa nga gratë shpreheshin se nuk ia vlen të raportosh, më së shumti sepse dhuna nuk është shumë serioze, por edhe sepse nuk të ndihmon dot njeri. Përveç kësaj, kishte gra që kishin frikë nga ajo që mund të ndodhte po qe se partneri informohej për raportimin. Studimi cilësor tregoi se gratë nuk kishin njohuri të mjaftueshme për shërbimet e specializuara si dhe nuk kishin besim tek institucione të tilla si policia (shih Kapitullin 5).

Megjithatë, duket se normat shoqërore po ndryshojnë në favor të të folurit hapur rreth dhunës dhe ka më shumë gjasa që gratë e reja të mos e konsiderojnë më çështje private dhunën në familje.

6 Gratë konsiderohen të ndikuara nga konflikti kur kanë jetuar në një situatë konflikti të armatosur për një periudhë prej së paku një jave dhe i përgjigjen me “po” të paktën njëres prej pyetjeve të listuara në Kapitullin 4.

7 *Gratë dhe burrat në Shqipëri 2018* (Tiranë: INSTAT, 2018), përdorur për herë të fundit më 3 shkurt 2019, <http://www.instat.gov.al/media/4764/burra-dhe-grate-ne-shqiperi-2018.pdf>.

Gjetjet e anketës dhe studimi cilësor vënë në pah tre përfundime kyçe:

Normat dhe qëndrimet kulturore në Shqipëri favorizojnë nënshtrimin e grave ndaj burrave dhe dhuna seksuale nga partneri intim pranohet në një shkallë të lartë.

Pjesa më e madhe e grave në Shqipëri mendojnë se ato duhet t'u binden burrave, kurse dhuna seksuale në marrëdhëniet intime është një dukuri e përhapur dhe normale. Të tilla mendime nxisin një mjedis që toleron dhunën ndaj grave.

Dhuna ndaj grave nuk raportohet në shkallën e duhur dhe, rrjedhimisht, gratë nuk arrijnë të përfitojnë gjithmonë nga shërbimet dhe mbrojtja e ofruar.

Ndonëse shumica e grave në Shqipëri mendojnë se dhuna ndaj grave është e zakonshme dhe pavarësisht se një në pesë gra pohojnë se kanë qenë objekt i dhunës fizike dhe/ose seksuale, shumica e tyre nuk e raportojnë dhunën në polici apo në institucione/organizata të tjera. Turpi, frika nga dhunuesi, mungesa e besimit të institucionet dhe mungesa e mbështetjes financiare pengojnë raportimin. Mekanizmi kombëtar i referimit është një hap në drejtimin e duhur për kapërcimin e këtyre pengesave, por duhet bërë më shumë për zhvillimin e kapaciteteve të plota të këtij sistemi.

Ekzistojnë boshllëqe në legjislacion dhe në zbatimin e tij si dhe në mbledhjen e të dhënave.

Kohët e fundit janë bërë shumë përmirësime në kuadrin ligjor dhe politikat përkatëse në Shqipëri, zbatimi i të cilave pritet të sjellë ndryshime në gjendjen e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore. Megjithatë, ende ekzistojnë boshllëqe, si ai i përkufizimit të përdhunimit në Kodin Penal, i cili e kushtëzon konfirmimin e kësaj vepre me përdorimin e forcës apo me kërcënimin për përdorimin e forcës, çka nuk është në përputhje me Konventën e Stambollit. Si ekspertët, edhe të mbijetuarat e dhunës, janë të mendimit se forcimi i ndjekjes penale për autorët është me rëndësi të veçantë.

Rekomandime

Rekomandimet në vijim bazohen në gjetjet e anketës, përfundimet e përvijuara në këtë raport, në studimin cilësor dhe në rezultatet e tryezës së rumbullakët⁸ me aktorët kryesorë të qeverisë dhe shoqërisë civile organizuar për konfirmimin e vlefshmërisë së tyre:

Për qeverinë:

1. Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere për dhunën seksuale, veçanërisht në marrëdhëniet me partnerin intim, në bashkëpunim me OSHC-të e grave.
2. Analiza e shkaqeve dhe pasojave për mos-reagimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse në përputhje me rregullat dhe legjislacionin. Kjo analizë do të shërbejë për të përgatitur rekomandime specifike për përmirësimin e punës së aktorëve dhe institucioneve përgjegjëse.

Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

3. Investimi në ngritjen e strehëzave për rastet urgjente dhe qendrave të tjera për trajtimin e përdhunimit, për luftën kundër stigmës dhe rritjen e nivelit të raportimit të dhunës seksuale, si dhe për të ofruar shërbime të përshtatshme shëndetësore dhe psikologjike për të mbijetuarat e dhunës seksuale.
4. Mbështetja e OSHC-ve në përpjekjet e tyre për të nxitur debatet midis brezave me qëllim shkëmbimin e këndvështrimeve dhe thyerjen e kulturës së heshtjes që rrethon dhunën ndaj grave. Në këtë drejtim mund të angazhohen më shumë gra aktiviste, veçanërisht në zonat e largëta dhe ato rurale, për të punuar me gra të tjera që ende e konsiderojnë dhunën si aspekt normal të martesës/ marrëdhënies.
5. Mbatja e takimeve informuese, veçanërisht me gratë e zonave rurale, rreth mjeteve, institucioneve dhe procedurave që ekzistojnë për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave.

8 Tryeza e rumbullakët u mbajt më 8 nëntor 2018 në Tiranë me pjesëmarrjen e 30 aktorëve kyç.

6. Trajnimi i punonjësve të shëndetësisë për një rol më aktiv të tyre në mekanizmat e referimit, nxitjen e grave për të raportuar rastet e dhunës, në përgjithësi, dhe për të mbështetur të mbijetuarat.
7. Të sigurohet menaxhimi efektiv i sistemit të REVALB-it në bashkëpunim me zyrtarët e bashkisë dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm.

Për Ministrinë e Drejtësisë:

8. Të sigurohet akses i duhur në ndihmë ligjore falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore.
9. Të trajnohen gjykatës dhe prokurorë mbi çështjet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe të trajnohen mbi legjislacione të reja të rëndësishme.
10. Të bashkëpunohet me të gjithë aktorët e angazhuar për të mbledhur të gjitha të dhënat e rëndësishme kombëtare mbi rastet e DHBGJ të ndjekura në gjykatë në një sistem qëndror të dhënash si dhe të vijohet me studime sistematike mbi të dhënat.

Për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë:

11. Institucionalizimi i një programi për djemtë dhe vajzat në shkollat nëntë vjeçare dhe të mesme, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, për parandalimin e pabarazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave që në moshë të hershme.

Për Ministrinë e Punëve të Brendshme:

12. Përdorimi i policimit në komunitet si një mjet parandalues për përmirësimin e komunikimit midis punonjësve të policisë dhe komunitetit, si një mënyrë efektive për rritjen e besimit tek policia dhe nxitjen e sa më shumë grave për raportimin e dhunës me bazë gjinore.
13. Të sigurohet mbledhja e të dhënave mbi krimet me bazë gjinore në bashkëpunim me aktorët përkatës si edhe të garantohet se të dhënat në lidhje me çështjet në gjykatë dhe ato nga sistemi REVALB ndahen me të gjithë aktorët e interesuar.

Për organet e Qeverisjes Vendore dhe mekanizmin lokal të referimit:

14. Forcimi i bashkëpunimit midis institucioneve qendrore dhe organeve të qeverisjes vendore. Shkëmbimi i përvojave më të mira të bashkive në të gjithë vendin për të ndihmuar njësitë e tjera vendore që ende nuk kanë ngritur mekanizma referimi efektive.
15. Ngritja dhe zbatimi i programeve për dhunuesit si pjesë e një reagimi të koordinuar të komunitetit, shoqëruar edhe me një sistem efektiv të drejtësisë penale dhe shërbime për të mbijetuarat, në mënyrë që të sigurohet një qasje e përqendruar tek viktima e cila ka prioritet sigurinë e viktimës.
16. Të sigurohet që sistemi REVALB të funksionojë për të gjitha bashkitë.

Për median

17. Mbështetja e trajnimeve për etikën në çështjet gjinore në mënyrë që media të trajtojë më mirë paragjykimet gjinore ekzistuese që prekin një audiencë të gjerë. Gjithashtu, trajnimi i gazetarëve të rinj për raportimin e drejtë të dhunës me bazë gjinore duke shmangur fajësimin e të mbijetuarave për dhunën e pësuar.




Rezultatet e studimit të OSBE-së - Shqipëria

Një studim sasior është kryer kryer mbi bazën e grave nga moshë 18-74 vjeç të cilat jetojnë në Shqipëri. Një total prej 1 858 intervistash janë realizuar ballë për ballë nga prilli deri në mesin e gushtit 2018. Këto të dhëna janë bazuar në profilin e popullsisë.

PREVALENCA E LARTË E FORMAVE TË NDRYSHME TË DHUNËS NDAJ GRAVE

PREVALENCA E LARTË E FORMAVE TË NDRYSHME TË DHUNËS NDAJ GRAVE



700 000*

gra kanë përjetuar një formë të ngacmimit seksual, përndjekje, dhunë të shkaktuar nga partneri intim, ose dhunë nga jo-partneri (përfshirë dhunën psikologjike, fizike apo seksuale) që nga moshë 15-vjeçare

170 000*


Gra kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim

120 000*


Kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jo-partneri

*Shifra të përafërta


NJË NË DHJETË GRA KA PËRJETUAR DHUNË FIZIKE DHE/OSE SEKSUALE NGA JO-PARTNERI



DHUNË E SHKAKTUAR NGA PARTNERI INTIM




DHUNA PSIKOLOGJIKE NGA PARTNERI INTIM ËSHTË FORMA MË E PËRHAPUR



Baza: Prevalenca e ngacimit seksual, përndjekja dhe dhuna e shkaktuar nga jo-partneri janë bazuar te gratë nga moshë 18-74 vjeç (1 858); Dhuna e shkaktuar nga partneri intim bazohet te gratë që gjithnjë kanë pasur partner (1 660)

NIVEL I ULËT RAPORTIMESH DHE NDERGJEGJËSIMI


SHUMË GRA NUK NDIHEN TË MIRINFORMUARA MBI ATË SE ÇFARË DUHET TË BËJNË NËSE PËRJETOJNË DHUNË



Baza: Të gjitha gratë nga mosha 18-74 vjeç (1 858)

NIVEL I ULËT RAPORTIMESH NË POLICI

% e atyre që kontaktuan policinë pas incidentit më serioz të dhunës



Baza: Të gjitha gratë nga mosha 18-74 vjeç, të cilat identifikojnë një incident më serioz të çdo forme të dhunës – partneri aktual (200), partneri i mëparshëm (68), jo-partneri (148), ngacmim seksual (419), përndjekje (168)

HESHTJA DHE QËNDRIME QË FAJËSOJNË VIKTIMËN

■ Totalisht dakord /kanë tendencën të jenë dakord ■ Totalisht jo dakord /kanë tendencën të mos jenë dakord

Përgjithësisht, miqtë tuaj do të ishin dakord ose jo me deklaratat e mëposhtme?

Gruaja e ka për detyrë të kryejë marrëdhënie seksuale me burrin edhe nëse ajo nuk ka dëshirë.



Është e rëndësishme që një burrë t'i tregojë gruas se kush komandon



Deri në çfarë mase jeni dakord me deklaratat e mëposhtme?



Dhuna në familje është çështje private dhe si e tillë duhet të zgjidhet brenda familjes




Baza: Të gjitha gratë nga mosha 18-74 vjeç (1 858)

NDIKIMI I INCIDENTEVE MË SERIOZE


DHUNA SHKAKTON VUAJTJE PSIKOLOGJIKE

% e atyre që kanë përjetuar një ose më shumë pasoja psikologjike si pasojë e:



DHUNA SHKAKTON VUAJTJE FIZIKE

% e atyre që kanë përjetuar një ose më shumë pasoja fizike si pasojë e:




Kjo përkthehet në **78 000 gra*** të cilat pësuan një lëndim fizik, apo pasoja psikologjike duke konsideruar rastet e incidenteve më serioze gjatë jetës së tyre.

*Shifra të përafërta

Baza: Të gjitha gratë nga mosha 18-74 vjeç, që cilësojnë ngacmimin seksual si formën më të rëndë të dhunës (419), përndjekjen (168), partneri aktual (200), partneri i mëparshëm (68), jo-partneri (148), çdo lloj dhune nga partneri intim ose jo-partneri (329)

*Shifrat në lidhje me dhunën psikologjike dhe dëmtimet fizike janë azhurnuar - shifrat në versionet e mëparshme të këtij raporti nuk duhet të merren parasysh

PËRVALENCA E DHUNËS NË ZONAT E BANUARA



■ Urbane ■ Rurale

Baza: Të gjitha gratë nga mosha 18-74 vjeç, që jetojnë në zona urbane (1 006), zona rurale (852); Ato që kanë pasur gjithnjë partner nga mosha 18-74 vjeç, që jetojnë në zonat urbane (891), zonat rurale (769)

Tabela e Përmbajtjes

Vështrim i përgjithshëm	i
Përmbledhje ekzekutive.....	iii
1. Si duhen lexuar të dhënat	1
2. Konteksti ligjor, institucional dhe politik	5
3. Qëndrimet kundrejt roleve gjinore dhe dhunës ndaj grave	13
4. Dhuna ndaj grave në Shqipëri	19
5. Konflikti dhe dhuna	37
6. Impakti i dhunës në jetët e grave dhe barrierat e të kërkuarit ndihmë	41
7. Përjetimi i dhunës nga grupe të veçanta të grave.....	55
8. Përfundimet dhe rekomandimet kryesore	61
Shtojcat	67



1. Si duhen lexuar të dhënat

Hyrje

Kjo anketë e realizuar nën drejtimin e OSBE-së është studimi i parë për përhapjen e dhunës ndaj grave në Republikën e Shqipërisë bazuar në një kampion përfaqësues të grave në moshë të rritur (1,858 gra të moshës 18-74 vjeç). Karakteristikat kryesore demografike të kampionit të studiuar janë moshja, gjendja e punësimit, të pasurit e një partneri, të pasurit e fëmijëve, banimi në zonat rurale apo urbane si dhe nëse ishin ndikuar nga konflikti apo jo. Studimi ka si objektiv kryesor mbledhjen e provave për përhapjen e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe pasojat e kësaj dhune në shëndetin dhe mirëqenien e grave në funksion të hartimit të politikave përkatëse. Studimi u përqendrua në këto çështje:

- Sa e përhapur është dhuna ndaj grave në Shqipëri?
- Cilat janë format e dhunës që përjetojnë gratë në Shqipëri?
- Kush janë autorët e dhunës ndaj grave?
- Cilat janë pasojat e dhunës në shëndetin dhe mirëqenien e grave?
- A raportohet dhuna e përjetuar nga gratë në polici, struktura apo organizata të tjera? Nëse jo, pse?
- A ndryshon dhuna ndaj grave në varësi të moshës së tyre, arsimit, statusit profesional, të ardhurave, përkatësisë në një grup minoritar apo zonës urbane/rurale ku jetojnë?

Studimi synon, gjithashtu, një kuptim më të mirë të çështjeve të parashtruara më lart, duke marrë në konsideratë konfliktet e armatosura të përjetuara nga gratë, sipas përcaktimeve të përdorura në këtë studim (për më shumë shih Kapitullin 4).

Anketa e udhëhequr nga OSBE-ja u kërkon grave të bëjnë dallimin midis incidenteve të ndodhura që në moshën 15 vjeçare dhe atyre të ndodhura përgjatë 12 muajve që i paraprijnë intervistës. Kjo siguron të dhëna lidhur me gjendjen aktuale të raportimit dhe reagimin e sistemit të ndihmës, të cilat kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për politikëbërjen.

Krahasueshmëria e të dhënave të anketës për rajonin me të dhënat e Bashkimit Evropian

Ky studim u bazua në metodologjinë e Agjencisë së BE-së për të Drejtat Themelore (FRA) në anketën e saj të vitit 2012 për dhunën ndaj grave në 28 vendet anëtare të Bashkimit Evropian.⁹ Për rrjedhojë, kjo anketë e udhëhequr nga OSBE-ja është e krahasueshme me anketën e Agjencisë FRA. Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) i përdor të dhënat e FRA-së në punën e tij të tanishme, ndërsa të dhënat e këtij studimi planifikon t'i përdorë në të ardhmen. Dhe në fund, anketa e OSBE-së përmban edhe pyetje të marra nga Eurobarometri¹⁰ në lidhje me qëndrimet kundrejt dhunës ndaj grave.

9 *Dhuna ndaj grave: anketim në të gjithë Bashkimin Evropian. Rezultatet kryesore* (Mjenë: Agjencia e BE për të Drejtat Themelore, 2015), përdorur për herë të fundit më 26 janar 2019, <http://fra.europa.eu/en/publication/2014/violence-against-women-eu-wide-survey-main-results-report>.

10 "Eurobarometri special 449: Dhuna me bazë gjinore", Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Drejtësinë dhe Konsumatorin, nëntor 2016, përdorur për herë të fundit, më 26 janar 2019, https://data.europa.eu/euodp/data/dataset/S2115_85_3_449_ENG.

Hezitimi për të folur

Për të kuptuar më mirë përhapjen e dhunës ndaj grave, rëndësi të madhe ka konteksti. OSBE-ja shtoi në pyetësor disa pyetje për normat, qëndrimet dhe sjelljet e grave dhe burrave në lidhje me dhunën dhe përvojat me raportimin e abuzimit. Krahasimi i të dhënave të OSBE-së me të dhënat e BE-së për qëndrimet dhe normat gjinore (Eurobarometri Nr. 449), tregon se aty ku numri i grave që mendojnë se dhuna në familje është një çështje private është më i madh, ato janë më pak të prirura për të raportuar dhunën në krahasim me vendet ku është punuar më gjatë për krijimin e ndërgjegjësimit për dhunën ndaj grave. Studimi cilësor e konfirmon këtë dukuri dhe tregon se tabuja dhe turpi për shkak të dhunës seksuale janë veçanërisht të përhapura.

Studimet e mëparshme

Instituti Kombëtar i Statistikave i Republikës së Shqipërisë (INSTAT) zhvilloi dy anketa kombëtare për përhapjen e dhunës kundër grave në familje në 2007 dhe 2013.¹¹ Meqenëse të dy anketat përdorën një metodologji të ngjashme, edhe rezultatet e tyre ishin të ngjashme.¹² Sipas anketës së vitit 2013, më shumë se gjysma e grave të intervistuar nga moshën 18 deri në 55 vjeç kishin përjetuar dhunë në familje gjatë jetës së tyre. Më e përhapura ishte dhuna psikologjike, me 58% të grave që pohonin përjetimin e kësaj forme të dhunës (gjatë jetës së tyre), pasuar nga dhuna fizike (24%) dhe dhuna seksuale (8%). Anketa tregoi se 25% e grave kishin përjetuar dhunë fizike dhe seksuale gjatë jetës së tyre. Krahasimi i rezultateve me ato të vitit 2007, zbuloi se përqindja e grave që kishin përjetuar dhunë në familje ishte rritur me 3 pikë përqindjeje. Përqendrimi më i madh i dhunës në familje rezultoi ndër gratë e divorcuara ose të ndara, gratë e reja (18-24 vjeç), gratë me nivel arsimor të ulët, gratë e papuna dhe gratë e zonave rurale. Përqindja e grave që e kishin raportuar dhunën ose kishin kërkuar ndihmë ishte shumë e ulët: në vitin 2013, vetëm 8% e grave të dhunuara në të shkuarën dhe 7% e grave që dhunoheshin aktualisht kishin kërkuar ndihmë për dhunën që kishin përjetuar ose përjetonin nga partneri intim. Ndër gratë që kishin kërkuar ndihmë, shumica (90%) ishin kthyer në familjen e origjinës. Në vitin 2013, përqindja e grave që kishin raportuar dhunën në polici ose kishin kërkuar ndihmë mjekësore, ligjore apo sociale kishte pësuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2008, por vazhdonte të ishte e ulët (15% kishin kërkuar ndihmë mjekësore, 14% kishin kontaktuar policinë dhe më pak se 10% kishin kërkuar forma të tjera ndihme). Sondazhi i vitit 2018 i INSTAT kishte një kampion prej 3,443 familjesh ku gratë e intervistuar i përkisnin grupmoshës 18-74 vjeç. Sondazhi i vitit 2018 tregon se një në dy gra shqiptare kanë përjetuar dhunë gjatë jetës së tyre. Gjashtëdhjetë e pesë përqind e grave të anketuara kanë përjetuar dhunë gjatë lidhjes së tyre me një partner, 47% kanë përjetuar dhunë nga partneri intim në marrëdhënie familjare, 1 në 5 gra kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale dhe 18.2% kanë përjetuar dhunë nga një jo partner. Gjetjet treguan se 46.5% e grave deklaruan se shumica apo pjesa më e madhe e njerëzve besojnë se një grua duhet të tolerojë dhunën për të mbajtur familjen të bashkuar. Hulumtimi i kryer nga OSBE dhe INSTAT plotësojnë njëri-tjetrin dhe ofrojnë më tepër thellësi dhe shpjegim të ndryshimeve që kanë ndodhur me kalimin e viteve.

Udhëzim për interpretimin e të dhënave të anketës

Kur shumatorja e përqindjeve nuk rezulton 100 apo e tejkalon atë, mund të shpjegohet për shkak të rrumbullakosjeve, përjashtimit të përgjigjeve "nuk e di" ose përgjigjeve të shumëfishta nga të anketuarat për pyetje të caktuara. Për të shënuar vlera më të vogla se 0.5% dhe më të mëdha se 0%, autorët e raportit kanë përdorur simbolin e yllit.

Privatësia dhe fshehtësia

Intervistat u zhvilluan ballë për ballë nga intervistuese gra të trajnuara dhe me përvojë. Ato u realizuan me ndihmën e tabletave në kushte privatësie, në përputhje me parimet e dhënies së pëlqimit, pas informimit të duhur të grave. Gratë e intervistuar u informuan se të gjitha të dhënat e grumbulluara do të ishin konfidenciale dhe anonime.

11 Metodologjitë e përdorura në anketat e INSTAT për shkallën e dhunës dhe ato të përdorura nga anketa e udhëhequr nga OSBE-ja janë të ndryshme dhe jo drejtpërdrejt të krahasueshme. Megjithatë, tendencat e përgjithshme të përhapjes së dukurisë janë të ngjashme.

12 Robin N. Haarr dhe Milika Dharmo, "Dhuna në Familje në Shqipëri: Anketim në shkallë vendi bazuar te popullsia", INSTAT, 2009, përdorur për herë të fundit më 3 shkurt 2019, https://mdhamo.files.wordpress.com/2010/01/domestic_violence_robin_final_5_24_09.doc; Robin N. Haarr, *Dhuna në Familje në Shqipëri: Anketimi 2013 në shkallë vendi bazuar te popullsia* (Tiranë: INSTAT dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim) përdorur për herë të fundit më 3 shkurt 2019, <http://www.in.undp.org/content/dam/albania/docs/Second%20Domestic%20Violence%20Survey%202013%20english.pdf>

Format e dhunës të studiuara nga anketa

Gjetjet e paraqitura në këtë raport bazohen te një sërë pyetjesh të përfshira në anketën e OSBE-së lidhur me dhunën ndaj grave nga individët jo-partnerë ose nga partnerët intimë, si dhe rastet e ngacmimit seksual, përndjekjes, dhunës në fëmijëri dhe ndikimit të konfliktit në dhunën me bazë gjinore. Pyetësi është bazuar në përkufizimet që përdor Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).

Për të matur përhapjen (e raportuar) të çdo forme të dhunës, gratë u pyetën nëse kishin përjetuar një sërë formash të dhunës në periudha të ndryshme reference, siç përshkruhet me hollësi në Kapitujt 4 dhe 5 të këtij raporti.

- Lidhur me **dhunën fizike** dhe **seksuale**, lista e pyetjeve të bëra mund të gjendet në faqen 24 të Kapitullit 4.
- Lidhur me **dhunën psikologjike**, lista e pyetjeve të bëra mund të gjendet në faqen 31 të Kapitullit 4.
- Sa i takon **ngacmimit seksual**, grave pjesëmarrëse në anketë iu bënë pyetjet në faqen 33 të Kapitullit 4.
- Për **përndjekjen**, grave iu drejtuan pyetjet në faqen 32 të Kapitullit 4.

Në këtë studim, dhuna në fëmijëri i referohet dhunës përpara moshës 15 vjeç. Për përvojat e dhunës në fëmijëri është hartuar një listë pyetjesh që mund të gjenden në faqen 39 të Kapitullit 4. Pyetjet, metodologjia dhe moshja e të intervistuarave në anketën e udhëhequr nga OSBE-ja ishin të ndryshme nga ato të përdorura në anketat për Përvojat e Vështira në Fëmijëri¹³si dhe në Grup-Anketat me Tregues të Shumëfishtë,¹⁴ për rrjedhojë shifrat e përhapjes së dhunës në fëmijëri nuk janë të krahasueshme.

Lidhur me kapitullin që trajton konfliktin dhe dhunën me bazë gjinore (Kapitulli 5), për qëllime të këtij studimi, **konflikti i armatosur** përcaktohet si luftë e armatosur midis dy ose më shumë grupeve të organizuara, sulme kundër komuniteteve ose pasiguri e përgjithshme e shkaktuar nga konflikti, kurse gra të ndikuara drejtpërdrejt nga konflikti konsiderohen ato gra që kanë jetuar në një situatë ku është zhvilluar një konflikt i armatosur për një periudhë prej së paku një jave dhe që i janë përgjigjur “po” të paktën një prej pyetjeve të renditura në faqen 45 të Kapitullit 5.

Partnerë quhen ata individë me të cilët të intervistuarat janë martuar, kanë bashkëjetuar ose kanë qenë të përfshira në një marrëdhënie pa bashkëjetesë. Individët jo-partnerë përfshijnë të gjithë dhunuesit e tjerë përveç partnerëve aktualë ose të mëparshëm të grave.

Incidenti më i rëndë është përcaktuar si incidenti me ndikimin më të madh, fizik apo psikologjik te gratë e intervistuarat.

Përmbledhje e studimit cilësor

Për realizimin e studimit cilësor në Shqipëri punuan pesëmbëdhjetë ekspertë kyç, të cilët ndanë pikëpamjet e tyre mbi gjendjen aktuale të institucioneve qeveritare dhe OJQ-ve që punojnë për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave, për ndihmën që mund të marrin gratë dhe vajzat e dhunuara dhe për rekomandimet që mund të ndikojnë në përmirësimet e nevojshme. Ndër këta ekspertë kishte përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të institucioneve qeveritare dhe joqeveritare.

13 Organizata Botërore e Shëndetësisë, Pyetësi Ndërkombëtar për Përjetimet Negative në Fëmijëri (ACE-IQ), përdorur për herë të fundit më 26 mars 2019, https://www.who.int/violence_injury_prevention/violence/activities/adverse_childhood_experiences/en/

14 Organizata Botërore e Shëndetësisë, Pyetësi Ndërkombëtar për Përjetimet Negative në Fëmijëri (ACE-IQ), përdorur për herë të fundit më 26 mars 2019, https://www.who.int/violence_injury_prevention/violence/activities/adverse_childhood_experiences/en/

Anketë e udhëhequr nga OSBE për dhunën ndaj grave në Shqipëri

U organizuan diskutime me shtatë fokus-grupe me gra të moshave të ndryshme, nga zonat urbane dhe rurale të Shqipërisë, përfshirë një fokus-grup me gra nga komuniteti rom. Këto diskutime synonin:

- të qartësonin qëndrimet shoqërore ndaj grave, në përgjithësi, dhe veçanërisht ndaj dhunës kundër grave dhe vajzave dhe qëndrimet e autorëve të kësaj dhune;
- të analizonin ndryshimet në qëndrimet kundrejt dhunës ndaj grave dhe vajzave përgjatë kohës, përfshirë edhe në periudha konflikti;
- të përcaktonin shkallën e njohurive të grave për mundësitë e mbështetjes, vlerësimin e tyre për sistemin e ndihmës dhe pengesat për t'iu drejtuar sistemit në rast nevoje; dhe
- të arrinin në përfundime për përmirësimin e sistemit parandalues dhe sistemit ekzistues të ndihmës për gratë e dhunuara.

U kryen edhe katër intervista të thelluara me të mbijetuarat e dhunës, duke përfshirë gratë me aftësi të kufizuara ose me probleme shëndetësore afatgjata. Qëllimet e këtyre intervistave ishin:

- shqyrtimi i formave të dhunës që gratë kanë përjetuar gjatë jetës së tyre dhe ndikimi i situatës së konfliktit në këtë dhunë;
- identifikimi i pengesave që kanë gratë për të folur rreth përvojave të tyre dhe për të kërkuar mbështetje, si dhe shqyrtimi i shkaqeve pse disa gra arrijnë të flasin për përvojat e tyre dhe të tjera jo;
- vlerësimi i mbështetjes së dhënë, identifikimi i hallkave që mungojnë në sistemin e shërbimeve dhe përcaktimi i nevojave të paplotësuara të grave nga grupe të caktuara minoritare (p.sh., gratë nga pakicat etnike ose gratë me aftësi të kufizuara); dhe
- në rastin e grave që kanë përfituar mbështetje (formale apo jo formale), të kuptuarit se si arritën të përfshihen në sistemin e ndihmës dhe si ka ndikuar kjo mbështetje.

2. Konteksti ligjor, institucional dhe politik

Ky kapitull shqyrton shkurtimisht kontekstin, legjislacin kyç në lidhje me dhunën ndaj grave¹⁵ si dhe parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e grave nga dhuna, grumbullimin e të dhënave dhe ndikimin e konfliktit tek gratë. Ai bazohet në pikëpamjet e 15 ekspertëve kryesorë të cilët janë intervistuar si dhe në një rishikim të literaturës, duke përfshirë Vëzhgimet Përfundimtare të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)¹⁶ dhe raportin e vlerësimit bazë për vitin 2017 nga Grupi i Ekspertëve kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO)¹⁷.

Hyrje

Dhuna ndaj grave dhe vajzave (DHnGV) ndikon në jetën e miliona grave dhe vajzave si dhe pengon përparimin drejt një sigurie gjithëpërfshirëse për të gjithë. OSBE-ja, si organizata më e madhe rajonale e sigurisë në botë, pranon se DHnGV jo vetëm që ndikon në sigurinë dhe mbrojtjen personale të grave, por gjithashtu i pengon ato të marrin pjesë në shoqëri apo të përdorin aftësitë dhe njohuritë e tyre maksimalisht.

Vëzhgimi i OSBE-së u fokusua në dhunën me bazë gjinore ndaj grave të kryer nga partnerët, anëtarët e familjes, miqtë, të njohurit, kolegët e tyre, apo edhe nga dhunues të panjohur.

Dhuna ndaj grave është një shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të grave dhe një manifestim i marrëdhënieve që historikisht kanë qenë të pabarabarta midis burrave dhe grave¹⁸. Meqenëse pabarazia gjinore është rrënja e dhunës me bazë gjinore, është e rëndësishme të merret parasysh konteksti më i gjerë i statusit të grave në rajonin e OSBE-së për të vlerësuar sigurinë dhe mirëqenien e tyre.

Në Shqipëri, si dhe në shumë vende të tjera në rajon dhe në mbarë botën, këto pabarazi strukturore janë të dukshme në fusha të ndryshme: në pjesëmarrjen politike dhe ekonomike; akses në burime, të ardhura dhe shërbime; pjesëmarrje në ekonomi; standardet e jetesës dhe cilësinë e jetës.

Shqipëria ka bërë hapa të jashtëzakonshëm përpara në rritjen e pjesëmarrjes së grave në degën legjislativë. Para se ligji për barazinë gjinore të miratohet në vitin 2008, numri i grave në parlament ishte vazhdimisht nën 10%. Vijoi më pas miratimi i kuotës 30% të kandidatëve gra në parlament, kështu, përfaqësimi i grave arriti 16%. Maksimalja u shënua në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, si rezultat i së cilës sot 29% e deputetëve janë gra¹⁹. Në nivel lokal, vendosja e një kuote prej 50% për kandidatët e këshillit bashkiak ka çuar në një rritje të konsiderueshme të përqindjes së grave në këto këshilla, që aktualisht është 37%, ndërkohë që 15% e kryetarëve aktualë të bashkive të vendit janë gra. Sa i përket qasjes në arsim, përqindja e vajzave që ndjekin arsimin e mesëm në krahasim me djemtë vazhdon të jetë e ulët. E kundërta ndodh me shifrat që i referohen arsimit të lartë, ku 67.9% e studentëve janë vajza dhe gra krahasuar me 44.6% djem dhe burra²⁰. Ka një mospërputhje të madhe mes numrit të lartë të grave me arsim të lartë dhe numrit të grave që aktualisht janë pjesë e tregut të punës. Rreth 50.3% e grave, krahasuar me 64.3% të burrave, ishin të punësuar në 2017, një përmirësim i lehtë krahasuar me vitet e mëparshme. Arsyeja krye-

15 Trafikimi i qenieve njerëzore dhe, më konkretisht, trafikimi i grave dhe vajzave për qëllime të shfrytëzimit seksual është një formë e dhunës me bazë gjinore ndaj grave. Është një çështje serioze e të drejtave të njeriut dhe një çështje sigurie. Ky studim nuk përfshiu pyetje mbi këtë lloj dhune, pasi hulumtimi i trafikimit të qenieve njerëzore përfshin një rrezik shumë të lartë për viktimat e saj dhe sondazhi për familjet nuk është metoda e përshtatshme kërkimore. Sondazhi i FRA mbi të cilin është bazuar sondazhi i OSBE-së nuk ka hetuar as trafikimin e grave dhe vajzave.

16 "Vërejtjet përmblyëse në raportin e katërt periodik të Shqipërisë", të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, Zyra e Komisionerit të Lartë, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), 2016, qasur më 3 shkurt 2019, https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/ALB/CO/4&Gjuha=en

17 Raporti i Vlerësimit i GREVIO-s mbi masat legjislativë dhe masa të tjera që i japin efekt dispozitive të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit): Shqipëria (Strasburg: Këshilli i Evropës, 2017) shkurt

18 Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, 1994

19 INSTAT, Burra dhe Gra nw Shqipëri 2018, p97

20 Ibid, f. 52

sore e pasivitetit të grave në tregun e punës është fakti se ato duhet të përmbushin detyrimet shtëpiake (31.6% e grave aktualisht nuk janë aktive në tregun e punës). I madh është kontrasti me burrat, pasi vetëm 2.1% e burrave janë të papunë për shkak të përgjegjësisë shtëpiake²¹.

Pabarazitë strukturore në tregun e punës gjithashtu manifestohen në hendekun gjinor të pagave, i cili shënoi një rritje nga 6.3% në 2016 në 10.5% në vitin 2017²², me sektorin prodhues që karakterizohet nga hendeku më i madh (22%)²³. Përveç kësaj, ndërsa 23% e grave ishin të punësuar në biznese familjare pa pagesë, në vitin 2017, me një status të tillë punësimi rezultoi në 12% e burrave.

Dhuna ndaj grave mund të kuptohet dhe trajtohet plotësisht brenda këtij konteksti, duke qenë se instrumentet që mund të jenë në gjendje ta eliminojnë atë janë të kufizuar ose të përforcuar nga veprime në fushat e tjera të jetës në të cilat gratë nuk janë të barabarta.

2.1: Kuadri ligjor kombëtar dhe zbatimi

Në dekadat që nga rënia e regjimit komunist, Shqipëria ka ratifikuar konventat kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore si dhe ka ndërmarrë hapa thelbësorë në nivel ligjor dhe politik për të adresuar barazinë gjinore në shoqëri. Kjo përfshin:

- Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1994) dhe Protokollin e saj Opsional (2003),
- Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim (1995) dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- Në vitin 2013, Shqipëria ratifikoi Konventën e vitit 2011 të Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
- Në 2015, Shqipëria miratoi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së (OZHQ), të cilat synojnë të trajtojnë sfidat globale, si varfëria, pabarazia dhe ndryshimet klimatike, si dhe të përmirësojnë qasjen në shëndetësi dhe arsim dhe të ndërtojnë institucione dhe partneritete të forta. OZHQ për barazinë gjinore, përfshin një numër objektivash specifike, duke përfshirë 5.2: "Eliminimin e të gjitha formave të dhunës kundër grave dhe vajzave në sferat publike dhe private, duke përfshirë trafikimin, shfrytëzimin seksual apo lloje të tjera shfrytëzimi"

Megjithatë, nuk është ende pjesë e Konventës së OKB-së mbi "Pëlqimi për Martesë, Moshë Minimale për Martesë dhe Regjistrimin e Martesave (1962).

Legjislacioni i Shqipërisë mbulon barazinë gjinore, dhunën në familje, ngacmimin seksual, sulmet seksuale dhe fizike, përdhunimin brenda martesës, raportimin e detyrueshëm dhe grumbullimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë:

- Ligji i vitit 2006 mbi masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare²⁴ synon parandalimin dhe zvogëlimin e dhunës në familje dhe garantimin e mbrojtjes për të mbijetuarit. Në vitin 2018, pas një vale rastesh të dhunës ndaj grave, ligji u ndryshua për të përfshirë mbrojtjen për viktimat që nuk ndanin banesën me dhunuesin, lëshimin e urdhrave të mbrojtjes paraprake dhe përfshirjen e fëmijëve në urdhrat e mbrojtjes.

21 Ibid, f. 69

22 Ibid, f. 64

23 Ibid, f. 75

24 Një përkthim në anglisht i ligjit shqiptar 966918 dhjetor 2006 (me ndryshimet e mëvonshme në vitin 2008 dhe 2010) "Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare është në dispozicion në faqen e internetit të Legjislacionit të OSBE-së në: <<http://www.osce.org/albania/> 30436? download = true>.

- Neni 130a i Kodit Penal²⁵ (2012, i ndryshuar në vitin 2013) e kriminalizon dhunën në familje. Kodi Penal konsideron vepra penale edhe përndjekjen (neni 121a), ngacmimin seksual (neni 108a) dhe përdhunimin, duke përfshirë përdhunimin brenda martesës (neni 102). Megjithatë, përkufizimi i përdhunimit bazohet në provën e përdorimit të forcës ose të një kërcënimi për përdorim të forcës dhe jo në mungesën e pëlqimit.
- Ligji i vitit 2008 për Barazinë Gjinore në Shoqëri përfshin dispozita kundër ngacmimit seksual dhe ngacmimit të bazuar në gjini, veçanërisht në marrëdhëniet e punës dhe ligji i vitit 2010 për Mbrojtjen nga Diskriminimi përfshin dispozita kundër diskriminimit gjinor.

Raporti i Komitetit të CEDAW 2016 “Përgëzoi Shqipërinë për përpjekjet në trajtimin e dhunës me bazë gjinore dhe ratifikimin e Konventës së Stambollit”. Ai vuri në dukje kriminalizimin e dhunës në familje dhe përdhunimin martesor, faktin se ndihma juridike u bë më e aksesueshme, që të mbijetuarve të dhunës iu siguroa ndihma ekonomike sipas një urdhri mbrojtjeje dhe se shumica e provave të nevojshme në rastet e ngacmimit seksual ishte reduktuar. Përveç kësaj, Komiteti vuri në dukje me shqetësim se: “Dhuna në baza gjinore mbetet ende një çështje e rëndësishme në vend: ajo nuk raportohet sa duhet, mekanizmat e dëmshpërblimit nuk njihen mirë dhe ekzistonte akoma ideja se raportimi do të sillte turp në familje apo dhe frika nga një hakmarrje e mundshme e dhunuesit²⁶”.

Shumica e ekspertëve të intervistuar për këtë studim ranë dakord me faktin se vërtetë korniza ligjore është gjithëpërfshirëse, por problemet në lidhje me zbatimin e kësaj të fundit mbeten, veçanërisht në aspektin e efektivitetit të urdhrave të mbrojtjes. Një studim dyvjeçar i monitorimit të gjykatës së rrethit në Tiranë tregoi se 74% e grave nuk kalojnë nëpër procesin e marrjes së një urdhri mbrojtjeje²⁷.

Sic vihet re edhe në raportin e GREVIO-s për Shqipërinë për vitin 2017, ekzistojnë mangësi ligjore dhe interpretime të ndryshme të ligjeve në praktikë. Kjo e bën më të vështirë për të mbijetuarit që të kenë akses në drejtësi dhe në shërbime të përshtatshme. Një nga këto sfida përse i përket zbatimit është “promovimi i një interpretimi të ngushtë të veprës penale të dhunës në familje ose nëpërmjet vendosjes së pajtimit të detyrueshëm në momentin kur aplikohet për lëshim të urdhrave [të menjëhershëm] të mbrojtjes”. Dobësi të tjera, sidomos në aspektin e mekanizmave referues kombëtarë, kanë të bëjnë me mungesën e zbatimit të duhur të urdhrave mbrojtës dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, përgjigjeve jo të përshtatshme nga sistemi i drejtësisë dhe njohurive të pamjaftueshme nga profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe ekspertët mjeko-ligjorë në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në raport me viktimat e dhunës²⁸. I njëjti raport vuri në dukje me shqetësim se “opinionin publik në Shqipëri nuk ka një ... koncept të qartë të [dimensionit gjinor] të dhunës ndaj grave dhe ... [që] ka një prirje për të nxitur faljen nën pretendimin e vlerave tradicionale të familjes”.

25 Një përkthim jozyrtar anglisht i Kodit Penal të Shqipërisë është në dispozicion në faqen e internetit të Euralius në: <http://www.euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation/send/10-criminal-law/56-criminal-sq-en>. Neni 130 / a i Kodit Penal.

26 Ibid.

27 Respektimi i të Drejtave të Viktimave / Mbijetuarve të Dhunës në Familje në Procesin Gjyqësor (Tirana: Qendra për të Drejtat e Njeriut në Demokraci, 2017). Online: <http://www.hrdc.al/index.php/en/news/56-monitoring-of-tirana-district-court-protection-orders>

28 Raporti i vlerësimit të GREVIO-së (Bazë).

Studimi cilësor tregoi se dhuna psikologjike, fizike dhe ekonomike ishin të gjitha përvoja të zakonshme për gratë. Dhuna psikologjike, që përfshin abuzimin verbal, sjelljen kontrolluese, kufizimin e lirisë, poshtërimin dhe kërcënimet, konsiderohej si forma më e zakonshme e dhunës në marrëdhënie pavarësisht se ku ka jetuar çifti, moshën ose nivelin e tyre arsimor. Në fakt, ajo ishte bërë aq e zakonshme dhe e pranuar nga shoqëria sa që as nuk konsiderohej dhunë, por një standard që tregon si trajtohen gratë në Shqipëri.

Gratë që morën pjesë në studimin cilësor shprehën besimin se dhuna psikologjike ishte një përvojë e zakonshme për gratë në Shqipëri dhe se ajo fillonte në një moshë të re. Gratë thanë se vajzat e reja shpesh i nënshtrohen kësaj lloji dhune nga baballarët dhe vëllezërit e tyre gjatë fëmijërisë dhe më pas i nënshtrohen partnerëve të tyre në momentin që martohej.

Dhuna psikologjike e ushtruar nga partnerët intim (DHPI) konsiderohet forma më e zakonshme e dhunës në Shqipëri, aq e zakonshme sa as nuk bënte më përshtypje, përveç rasteve kur situata ishte vërtetë e rëndë. Gratë në studimin cilësor mundën të jepnin edhe shembuj të shumë të dhunës psikologjike që kishin përjetuar, dëshmuar apo dëgjuar.

“Vjen burri në shtëpi. ‘Çfarë ke bërë sot? Pse e bërë këtë? Pse nuk e bërë atë? Unë të thash të bëje këtë!’ Ajo përpiqet të justifikojë atë që bëri. Ai zemërohet dhe fillon ta fyejë. Pastaj fillon një debat i nxehtë, ku ai humbet qetësinë. Gruaja nuk mund të bëjë asgjë, por të tërhiqet, të justifikojë veten ose të dridhet. Katër ose pesë orë kalojnë pa folur me njëri-tjetrin. Ai thotë se dëshiron të hajë. Ajo thotë, ‘Merre bëje vetë.’ E gjithë kjo situatë dëmton fëmijët. Vjen dita tjetër, përsëri ata grinden për diçka tjetër. Pra, burrat nuk janë tolerantë. Dreka nuk është gati në orën 13:00, por nuk është fundi i botës. Ai duhet të presë gjysmë ore. Kjo situatë nuk të çon askund”.

Grua nga mosha 36-50 vjeç, urbane

Për disa gra, dhuna psikologjike u bë aq e ashpër sa ato nuk kishin më kontroll mbi jetën e tyre. Disa nga gratë që kishin përjetuar këtë lloj dhune thanë se ishin ndaluar të kishin ndonjë kontakt me miqtë apo familjen, nuk u lejohej të punonin dhe nuk mund të largoeshin nga shtëpia. Gratë me këto përvoja përshkruan ndikimin afatgjatë që kjo dhunë kishte në shëndetin e tyre mendor dhe ndjenjën e vetëvlerësimit. Ato që kishin përjetuar dhunë fizike gjithashtu thanë se ndikimi i dhunës psikologjike ishte më serioz dhe kishte efekt më të gjatë se çdo keqtrajtim tjetër fizik që kishin përjetuar.

“Nëse nuk ju lejohej të bëni diçka dhe nëse shërbeni vetëm si një top futbollit në këmbët e një burri, me njerëz që ju përdorin, duke ju urdhëruar, ky është lloji më i keq i dhunës. Pse e them këtë? E them këtë sepse kjo ju privon nga identiteti juaj. Ju nuk keni respekt për veten tuaj. Ju nuk mund të merrni ndonjë vendim për veten tuaj. Pra, jeta juaj është në duart e dikujt tjetër, ndërsa jeta e bashkëshortit tuaj nuk është me të vërtetë në duart tuaja”.

Mbijetuese e dhunës

Në të vërtetë, gjetjet e sudimit tregojnë se më shumë se tre në pesë gra që kanë pasur ndonjëherë një partner, kanë hasur dhunë psikologjike të shkaktuar nga partneri aktual ose i mëparshëm (62% në krahasim me mesataren e BE-së prej 43%). Tetëmbëdhjetë përqind e grave që kanë qenë në një marrëdhënie thonë se kanë përjetuar dhunë psikologjike të shkaktuar nga partneri intim 12 muaj para studimit⁵⁸.

Format e ndryshme të dhunës psikologjike u ndanë në katër kategori të gjera si më poshtë⁵⁹:

Më shumë se tre në pesë gra që kanë pasur ndonjëherë një partner deklarojnë se kanë hasur dhunë psikologjike nga ana e partnerëve të tyre të tanishëm ose të mëparshëm

58 Shih aneksin 3, SDG 5.2.1 për detaje mbi mënyrën se si përlogaritet prevalenca 12 mujore e dhunës psikologjike.

59 Format e dhunës psikologjike gjenden me shkrimin italik nuk u pyetën për studimin e FRA.

Dhuna ekonomike, përfshin ndalimin e marrjes së vendimeve për financat familjare dhe blerjen në mënyrë të pavarur dhe ndalimin e punës jashtë shtëpisë.

Kontrollimi i sjelljeve, që përfshin situata ku partneri i gruas përpigjet të mos lejojë atë që të takojë miqtë e saj, kufizon përdorimin e faqeve të mediave sociale (si Facebook, Twitter, etj.), përpigjet të kufizojë kontaktin me familjen e saj të lindjes ose të afërmit, këmbëngul duke dashur të dijë se ku është në një mënyrë që shkon përtej shqetësimit të përgjithshëm, zemërohet nëse ajo flet me një burrë tjetër, dyshon se ajo ka qenë e pabesë, *ndalon përdorimin e kontrceptivit ose ndryshe kufizon vendimet për planifikimin familjar, pengon që ajo të përfundojë shkollën ose të fillojë një kurs të ri, dëshiron të vendosë ai se çfarë rrobash mund të veshë ajo ose pret që ajo t'i kërkojë leje për t'u kontrolluar tek një mjek.*

Sjelljet abuzive, të cilat përfshijnë situata ku partneri i gruas *e ndalon atë që të largohet nga shtëpia ose e ndalon atë të largohet nga shtëpia pa u shoqëruar nga një i afërm*, heq çelësat e saj të makinës ose e mbyll atë brenda, e ul ose e poshtëron para njerëzve të tjerë ose privatisht, e frikëson ose e ndrydh atë me qëllim (p.sh., duke bërë titur apo shkatërruar gjëra), e bën atë të shohë materiale pornografike kundër dëshirës së saj, kërcënon të lëndojë ose të vrasë dikë që kujdeset për të (përveç fëmijëve të saj), e kërcënon atë me akte të dhunshme seksuale si (përdhunimi, shtatëzani e detyruar, etj.) *e lëndon ose e kërcënon kur ajo viziton, merr ose sjell përsëri fëmijët e saj (vetëm partner i mëparshëm).*


Shantazhon një grua me fëmijët e saj ose se do të abuzojë me fëmijët e saj, kjo përfshin kërcënimin se do t'i largojë fëmijët, duke e kërcënuar se do t'i lëndojë fëmijët, duke i dëmtuar fëmijët ose duke e kërcënuar në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve të saj (vetëm partnerët e mëparshëm).

Gratë që janë në një marrëdhënie janë pyetur nëse këto gjëra kanë ndodhur ndonjëherë, shpesh ose gjatë gjithë kohës ose nuk kanë ndodhur kurrë, ndërsa gratë që kishin qenë në marrëdhënie të mëparshme u pyetën nëse ndonjë nga partnerët e tyre të mëparshëm kishte bërë ndonjëherë ndonjë nga këto gjëra kundrejt tyre⁶⁰.

Në përgjithësi, 50% e grave që kanë pasur ndonjëherë një partner kanë përjetuar sjellje kontrolluese dhe 41% sjellje abuzive. Një në pesë (22%) thonë se kanë përjetuar dhunë ekonomike, ndërsa 11% e grave me partnerë me të cilët kanë fëmijë thonë se janë shantazhuar përmes fëmijëve të tyre ose se do të abuzonin me fëmijët e tyre.

60 Në lidhje me kërcënimin me dhunë fizike ose seksuale, gratë u pyetën sa herë partneri tyre aktual ose ai i mëparshëm e kishin bërë këtë gjë dhe nëse po, sa herë e kishin bërë atë në 12 muajt para sondazhit.

Figura 4.2: Përhapja e formave të ndryshme të dhunës psikologjike e shkaktuar nga partneri intim



Të tre format e dhunës psikologjike që përmenden më së shpeshti në lidhje me partnerët aktual është fakti se këta të fundit duan të dinë me një insistim përtej normales se ku po shkon gruaja (31% kundrejt 8% në BE), duke e shtypur ose poshtëruar privatisht (29% kundrejt 11% në BE) dhe rasti kur partneri zemërohet shumë nëse gruaja flet me një burrë tjetër (27% kundrejt 9% në BE). Këto janë gjithashtu format më të zakonshme të dhunës të treguara në lidhje me një partner të mëparshëm, së bashku me dyshimin se gruaja është e pabesë. Ndërkohë që të tre format e dhunës psikologjike nga partnerët aktualë janë gjithashtu format më të zakonshme që mbizotërojnë në BE, përhapja është tre deri në katër herë më e lartë në Shqipëri.

4.2: Përndjekja

Trembëdhjetë përqind e grave janë përndjekur⁶¹ në një moment të caktuar që kur kanë qenë 15 vjeç. Kjo është më e ulët se mesatarja e BE-së prej 18%, e cila varion nga 8% në Rumani në 33% në Suedi, edhe pse është në përputhje me përhapjen në Kroaci prej 13%. Katër përqind e grave e kishin përjetuar këtë në 12 muajt para studimit. Format më të zakonshme të kërcënimeve janë thirrje fyese, kërcënuese ose telefonata të heshtura (7%, krahasuar me mesataren e BE-së prej 11%) dhe përndjekja e qëllimshme (5%, krahasuar me 8% në BE). Midis atyre që janë përndjekur, gratë nga moshë 18-39 vjeç kanë më shumë gjasa se gratë më të vjetra në moshë të tregojnë se kanë marrë email dhe mesazhe të shkruara dhe këto i kanë kategorizuar si incidentin më të rëndë që kanë përjetuar.

Autorët e përndjekjeve kanë më shumë gjasa të jenë të panjohur për gruan (69%), por 11% e grave që e kanë përjetuar përndjekjen, pohojnë se është shkaktuar nga partneri aktual ose i mëparshëm dhe 19% pohojnë se ka ndodhur nga dikush që gruaja e njihnte (por që nuk u identifikuan më tej) nëse ai ishte apo jo dhunuesi.

Në 49% të rasteve më serioze, përndjekja përfundon pas disa ditësh, dhe në 74% të rasteve ajo përfundon në më pak se tre muaj. Gjithsesi, ndonjëherë, ajo ka vazhduar për një kohë të gjatë. Në 14% të rasteve, për shembull, ajo zgjat mbi dy vjet dhe në 8% mbi pesë vjet krahasuar me mesataren e BE-së, ku përndjekja zgjat mbi dy vjet në 10% dhe mbi 5 vjet në 11% të rasteve.

Përvoja më serioze në përgjithësi e ka bërë gruan të ndihet e zemëruar apo e mërztur (42% dhe 38%), por në 35% të rasteve, ajo gjithashtu e ka bërë atë të ndihet e frikësuar. Vuajtja ishte emocioni më i zakonshëm midis 18-29 vjeçarëve (46%), pasuar nga frika (42%).

61 Në lidhje me përndjekjen, grave që ishin pjesë e sondazhit ju bënë këto pyetje: Që kur keni qenë 15 vjeç deri tani/ në 12 muajt para sondazhit, ka ndodhur që i njëjti person, në mënyrë të përsëritur t'ju ketë bërë këto gjëra: 1. Ju ka dërguar email, mesazhe me tekst, ose mesazhe direkte që ishin të natyrës frikësuese apo kërcënuese? 2. Ju ka dërguar letra që ishin të natyrës frikësuese apo kërcënuese? 3. Ju ka bërë telefonata kërcënuese? 4. Ka postuar komente negative rreth jush në internet? 5. Ka ndarë foto apo video tuajat intime në internet apo nëpërmjet celularit? 6. Ju ka qëndruar e pritur jashtë shtëpisë, punës, shkollës pa asnjë arsye të vërtetë? 7. Ju ka ndjekur qëllimisht vërdallë? 8. Qëllimisht ka hyrë dhe dëmtuar pronën tuaj? Përhapja e përndjekjes është bazuar tek të anketuarit që kanë raportuar të kenë përjetuar një ose më shumë forma të përndjekjes së mësipërme.

Pasojat psikologjike afatgjata përfshijnë ankthin (22%) dhe vështirësitë në gjumë (22%). Gratë nga moshën 18-29 vjeç kishin më shumë gjasa se mesatarja të ndiheshin të pambrojtura (24% në krahasim me 14% në përgjithësi).

Pas incidentit më të rëndë, pothuajse gjysma e grave ishin folur për këtë me miqtë ose të afërmit (48%, krahasuar me 77% në BE). Në rreth një të katërtën e rasteve, gruaja është përballur me dhunuesin (24% kundrejt 43% në BE), ndërsa në 15% të rasteve ajo e ka kërcënuar këtë të fundit me lajmërim të policisë apo marrjen e ndonjë mase ligjore. Policia u informua për rreth 13% të rasteve të incidenteve më të rënda (krahasuar me 26% në BE, duke filluar nga 8% në Greqi në 40% në Austri). Ato që kanë fëmijë kanë më shumë gjasa të kenë raportuar përndjekjen (16% në krahasim me 2%). Arsyeja kryesore për mos raportimin e incidentit më serioz në polici ishte se viktimat vendosën të merrej vetë me të apo të përfshinte miqtë / familjen (49%) ose ato mendonin se çështja nuk ishte mjaftueshëm serioze sa për t'u raportuar (35%).

4.3: Ngacmimi seksual

Tridhjetë e katër përqind e grave tregojnë se kanë përjetuar të paktën një formë të ngacmimit seksual⁶² (siç renditet në Tabelën 4.4) që kur ato ishin 15 vjeç.


Shtatëmbëdhjetë përqind e grave thonë se kanë përjetuar ngacmim seksual në 12 muajt para sondazhit. Dhe 17% deklarojnë se kanë përjetuar ngacmime seksuale më serioze, duke përfshirë 8% në 12 muajt para sondazhit⁶³.

Një e treta e grave kanë përjetuar ngacmim seksual që nga moshën 15 vjeç

62 Në lidhje me ngacmimin seksual, grave pjesë e sondazhit ju bënë këto pyetje: Që kur keni qenë 15 vjeç deri tani/ në 12 muajt para sondazhit keni përjetuar ndonjërin nga këto: 1) "prekje, puthje, përqaqime të padëshiruara"? 2) komentet seksuale apo shaka që ju kanë ofenduar? 3) Ftesa të papërshtatshme për të dalë? 4) pyetje të tepërta në lidhje me jetën tuaj private që ju kanë ofenduar? 5) Komente të tepërta në lidhje me pamjen tuaj që ju kanë ofenduar? 6) Vështrime apo ngulitje e syve në mënyrë të papërshtatshme që ju ka frikë suar? 7) dikush që dërgon ose ju tregon fotografi, foto ose dhurata seksualisht eksplicite që ju ofenduan? 8) dikush që është ekspozuar qëllimisht para jush, 9) dikush ju ka bërë të shikoni material pornografik kundër dëshirës tuaj, 10. Emaile apo sms me përmbajtje seksuale të padëshiruara që ju kanë ofenduar? 11) Gjëra të tepërta që ju kanë ofenduar në faqet e rrjeteve sociale si Facebook ose në dhomat e bisedave në internet? Në lidhje me çdo formë të ngacmimit seksual, gratë mundën të tregonin nëse ato e kishin përjetuar atë kurrë, një herë, dy deri pesë herë, gjashtë herë ose më shumë. Përhapja e ngacmimeve seksuale bazohet në të anketuarat të cilat kanë raportuar se kanë përjetuar një nga mënyrat e listuara më sipër, të paktën një herë. Gjashtë forma të ngacmimit seksual u përzgjedhën përse i përket ashpërsisë së tyre, dhe ato përmenden në këtë raport si "format më të rënda" të ngacmimeve seksuale.

63 Format më serioze të ngacmimeve seksuale raportohen të kenë qenë "prekje, puthje, përqaqime të padëshiruara", "komentet seksualisht sugjестive apo shaka që ju kanë ofenduar", "dikush që dërgon ose ju tregon fotografi me përmbajtje të qartë seksuale, foto ose dhurata që ju kanë ofenduar", "dikush që është ekspozuar qëllimisht para jush," dikush ju ka bërë të shikoni material pornografik kundër dëshirës tuaj" dhe emaile apo sms me përmbajtje seksuale të padëshiruara që ju kanë ofenduar". Përhapja e formave më të rënda të ngacmimit seksual bazohet në të anketuarat të cilat raportojnë se kanë përjetuar së paku një nga këto gjashtë forma të ngacmimit seksual në të paktën një rast.

Figura 4.3: Përhapja e ngacmimit seksual



Përqindja mesatare e grave në BE që deklaruan se kishin përjetuar ngacmime seksuale është 55%, duke filluar nga 24% në Bullgari në 81% në Suedi. Shifra për Shqipërinë është më e ulët se mesatarja e BE dhe gjithashtu më e ulët se ajo e Kroacisë (41%). Vendet me tradita më të gjata të politikave të barazisë gjinore dhe fushata ndërgjegjësimi (vendet nordike dhe Evropa perëndimore) gjithashtu kanë shkallë më të lartë të grave që ndajnë përvojat e tyre të ngacmimeve seksuale.

Gratë më të reja tregojnë më shpesh se ato kanë përjetuar ngacmime seksuale: 54% e 18-29 vjeçareve kanë pasur një ose më shumë përvoja të tilla që nga moshë 15 vjeç krahasuar me 27% të 40-49 vjeçareve, 25% të 50-59 vjeçareve dhe 18% e atyre mbi 60 vjeç.

Gratë në hulumtimin cilësor thanë se ato mendonin se ishte mjaft e zakonshme që gratë të përjetonin ngacmime seksuale në vende publike ose në vendin e punës. Ato thanë se ngacmimi seksual jashtë marrëdhënieve intime shihej si i papranueshëm nga shoqëria, por për të cilën flitej rrallë.

Ngacmimi seksual mbulon një gamë të gjerë të përvojave. Forma më e zakonshme e tre-guar nga gratë që nga moshë 15 vjeçare është kërcënimi përmes vështrimeve apo ngulitjes së syve, e cila është përmendur nga 21% e grave, e ndjekur nga pyetjet të bezdisshme për jetën e tyre private (13%) (Tabela 4.4). Në BE, vështrimi apo ngulitja e syve është lloji më i zakonshëm (30%), i ndjekur nga afër nga prekja, puthja, përçafimi i padëshiruar (29% mesatarisht në BE në krahasim me 7% në Shqipëri).

Tabela 4.4: Përhapja e formave të ndryshme të ngacmimit seksual

Ndonjëherë mund të keni takuar njerëz që ndaj jush janë sjellë në një mënyrë që ju ka bërë të ndiheni të padëshiruar dhe të fyer. Sa herë, që kur keni qenë 15 vjeç, deri tani, keni përjetuar ndonjë nga këto?

	Kurrë %	Njëherë %	2-5 herë %	6+ herë %
Një prekje, përqaqim, puthje e padëshiruar	92	3	3	1
Një mënyrë e papërshtatme e të ngulurit të syrit apo keqdashje që ju ka bërë të ndiheni e frikësuar	78	4	9	9
Komente apo shaka me përmbajtje seksuale që ju kanë bërë të ndiheni e ofenduar	90	2	5	2
Dikush që t'ju ketë dërguar apo treguar piktura, foto me përmbajtje të qartë seksuale dhe ju kanë bërë të ndiheni e ofenduar.	97	1	1	1
Ftesa të pa përshtatshme për të dalë në një takim	90	3	5	2
Pyetje të tepërta mbi jetën tuaj personale që ju kanë bërë të ndiheni e ofenduar.	87	3	6	3
Komente të tepërta mbi pamjen tuaj fizike që ju kanë bërë të ndiheni e ofenduar.	90	3	4	3
Emajle me përmbajtje të padëshirueshme seksuale që ju ka bërë të ndiheni e ofenduar.	88	2	2	1
Veprime të pa përshtatshme që ju kanë fyer në faqet e mediave sociale si, Facebook, ose në faqe ku mund të bisedohet në internet	81	2	2	1
Dikush që në mënyrë të turpshme të jetë ekspozuar para jush	96	2	1	0.4
Dikush që t'ju ketë bërë të vështroni apo të shihni materiale pornografike kudër dëshirës tuaj	97	0.2	0.1	0

BAZA: 1,858 gra nga 18-74 në Shqipëri

BURIMI: OSBE-ka bërë një studim mbi dhunën ndaj grave (2018)

Gratë që kanë përjetuar ngacmime seksuale më së shpeshti thonë se kjo është kryer nga dikush që ato nuk e njihnin (73%, në krahasim me mesataren e BE-së prej 68%) Megjithatë, 30% e grave në Shqipëri (të ngjashme me mesataren e BE-së prej 31% përmendin një mik, të njohur ose ndonjë fqinj, ndërsa 39% e grave (35% në BE) përmendin dikë tjetër që e njohin por që nuk specifikojnë më shumë⁶⁴.


Ndërsa autorët e ngacmimeve seksuale priren të jenë burra (burrat janë të përfshirë në 91% të rasteve), nuk është gjithmonë ky rasti. Për shembull, kur kryhet nga familja e një gruaje ose familja e partnerit të saj, ka më shumë gjasa të jetë një grua sesa një burrë, ndërsa në dy të tretat e rasteve janë kryer nga një mik ose i njohur, dhunuesja ishte një grua (27% thonë se ishte një grua, 35% thanë se ishin përfshirë të dy, si burri dhe gruaja dhe 38% që përfshinte vetëm një burrë). Në një të pestën e rasteve të incidenteve më të rënda, ishte përfshirë më shumë se një person (20%).

64 Kategoritë ishin "partneri aktual", "partneri i mëparshëm", "shefi / mbikëqyrësi", "kolegu / bashkëpunëtori", "klient / blerës / pacient", "mësues / trajner", "shok-student", "doktor/ punëtor shëndetësor", "kushëri/anëtar i familjes (përveç partnerit)", "kushëri i partnerit / anëtar i familjes së partnerit", "dikush me të cilin do dilni në takim/ dikush që sapo keni takuar".

4.4: Dhuna fizike dhe seksuale e shkaktuar nga jo partneri

Sipas rezultateve të anketimit në përgjithësi, 11% e grave deklarojnë se kanë përjetuar një ose më shumë forma të dhunës fizike të shkaktuar nga një jo partner që kur ishin 15 vjeç (2% në 12 muajt para sondazhit) ndërsa 1% thonë se i janë nënshtruar formave të dhunës seksuale (0.2% në 12 muajt para sondazhit) (Figura 4.4). Në përgjithësi, 11% tregojnë se kanë përjetuar dhunë fizike dhe / ose seksuale të shkaktuar nga një jo partner që nga moshën 15 vjeçare. Këto rezultate janë më të ulëta se mesatarja e BE-së ku 20% e grave kanë përjetuar dhunë fizike të shkaktuar nga partneri (duke filluar nga 10% në Austri, Greqi, Poloni dhe Portugali deri në 36% në Danimarkë). Gjashtë përqind e grave në BE kanë përjetuar dhunë seksuale të shkaktuar nga një jo partner, duke filluar nga 1% në Greqi dhe Portugali në 12% në Suedi. Dhuna e shkaktuar nga jo partneri më shpesh raportohet nga 30-39 vjeçarët (15%) dhe më pak nga gratë mbi 60 vjeç (6%). Gratë që pajtohen se dhuna në familje është një çështje private kanë më shumë gjasa të thonë se kanë përjetuar dhunë të shkaktuar nga jo partneri se sa ato që nuk pajtohen me këtë ide (14% kundrejt 9%).

Figura 4.4 Përhapja e dhunës fizike/seksuale e shkaktuar nga jo-partneri




Gratë thonë se forma më e përhapur e dhunës fizike që ato kanë përjetuar që në moshën 15 vjeçare dhe që është shkaktuar nga jo partneri është ajo e të qëlluarit me shpullë, e cila përmendet nga 8% e grave, njësoj si mesatarja e BE-së. Dy përqind e grave e përjetuan këtë në 12 muajt para studimit. Midis 0.3% dhe 0.5% e grave thonë se kanë përjetuar çdo formë të dhunës seksuale rreth së cilës janë pyetur.

Incidentet më serioze (që do të thotë, incidenti që ka patur më shumë impakt tek gruaja, duke përfshirë edhe kërcënimet e dhunës) që janë shkaktuar nga jo-partnerët (Figura 4.5) përfshijnë të qëlluarit me shpullë, e cila përmendet nga 33% e grave dhe duke u kërcënuar me dhunë fizike ose duke u shtyrë ose përplasur, secila nga këto forma janë cituar nga rreth një në tetë gra që kanë përjetuar ndonjëherë ndonjë formë dhune të shkaktuar nga një jo-partner.

Figura 4.5: Incidenti më serioz që i ka ndodhur grave nga jo partneri


Do doja që të mendonit për incidentin më serioz që është shkaktuar nga jo partneri. Cilat nga gjërat në këtë skedë ju ndodhi atëherë? Kur themi “më serioz” i referohemi atij incidenti që ka patur impaktin më të madh tek ju.



Pesëdhjetë e nëntë përqind e incidenteve më serioze kanë ndodhur në shtëpinë e gruas (gjë që flet për më shumë se dyfishin e mesatares së BE-së prej 27%) dhe 22% e incidenteve të tilla kanë ndodhur në një shtëpi private ose në një apartament (Figura 3.10).

Figura 4.6: Vendndodhja e incidentit më serioz të shkaktuar nga jo partneri

Nëse mendoni për incidentin më serioz të dhunës nga një jo partner, mund të tregoni ku ka ndodhur ai?



4.4.1: Dhunuesit

Shumica e dhunës fizike të shkaktuar nga jo-partneri në Shqipëri kryhet nga një person i njohur për gruan, veçanërisht nga një anëtar i familjes ose kushëri (duke mos përfshirë partnerët, 62%), të afërmit e partnerit të tyre (9%), një mik, ose dikush tjetër që ata e njihnin, por që nuk e specifikuan më shumë nga kategoritë e paraqitura (43%)⁶⁵. Ndërsa të afërmit ishin gjithashtu të përmendur si ndër dhunuesit më të shpeshtë në BE, ato përmenden më rrallë (me 31% në BE krahasuar me 7% në Shqipëri), ndërsa dikë të cilin viktimat nuk e njeh është përmendur më shumë në BE (31%) sesa në Shqipëri (5%).

Burrat, jo partner, janë identifikuar si autorë të dhunës fizike nga 65% e atyre grave që kanë përjetuar dhunë të shkaktuar nga jo partneri, ku 40% e të mbijetuarave përmenden vetëm burrat dhe 25% që thonë se të dy gjinitë janë përfshirë. Gratë janë identifikuar në 53% të rasteve (me rreth 28% ku përmenden vetëm gratë). Pjesa tjetër (7%) nuk e njeh gjininë e dhunuesit ose nuk preferon ta thotë.

Në tre nga katër prej incidenteve më serioze, dhunuesit kanë vepruar vetëm. Një e katërta e incidenteve më serioze janë kryer nga dikush që ka qenë i dehur (22%) ose nën ndikimin e drogës (2%).

Gratë pjesëmarrëse në studimin cilësor thanë se dhunuesit jo partnerë janë kryesisht nga familja e lindjes së viktimës (zakonisht gjatë fëmijërisë, por jo domosdoshmërisht) ose familjes së bashkëshortit të saj, gjë që reflektohet në rezultatet e studimit.

Dhunuesit brenda familjes së lindjes përfshijnë nënën, babanë, prindërit, vëllezërit e motrat, hallat dhe xhaxhallarët. Dhunuesit brenda familjes së burrit janë kryesisht prindërit, pasi çifti zakonisht jeton me ta, por këtu mund të përfshihet edhe e gjithë familja.

Gratë pjesëmarrëse në studimin cilësor shprehën besimin se lloji kryesor i dhunës i kryer nga anëtarët e familjes është dhuna psikologjike, kryesisht abuzimi verbal dhe sjellja kontrolluese. Ato përshkruan se si që në moshë të re, anëtarët e familjes së tyre, duke përfshirë xhaxhallarët dhe kushërinjtë, nuk i lejonin ato që të takonin miqtë e tyre ose të largoheshin nga shtëpia. Ato gjithashtu u shprehën se zgjedhjet në lidhje me jetën e tyre nuk qenë marrë nga vetë ato, psh: ishin detyruar ta linin shkollën që në moshë të vogël, apo ishin detyruar të martoheshin me dikë, kundër vullnetit të tyre.

Në momentin që martohen, gratë priren të jetojnë me familjen e bashkëshortit të tyre. Për disa, kjo do të thotë se, përveç dhunës së shkaktuar nga partneri intim, ato iu nënshtruan edhe dhunës psikologjike (dhe në disa raste fizike) të ushtruar nga vjehrra, zakonisht nga vjehrra e tyre. Kjo përfshinte abuzime verbale, sjellje shumë kontrolluese dhe kërcënime. Në një rast, vjehrra e njëres grua, kishte hedhur në drejtim të saj sende të forta si dhe e kërcënoi se do ta vriste. Kishte natyrë tejmase kontrolluese dhe ofendonte gruan verbalisht.

“Episodi im i parë i dhunës fizike ishte një javë pasi u martova, sepse nuk e kisha djegur si duhej drurin në kopësht. Arsyeja kryesore që ishte dhe shkaku i sjelljes abuzive të burrit tim ishte se ai i prishte lekët duke luajtur bixhoz apo bilardo me shokët e vet. Ai ishte xheloz dhe besonte se vrazhdësia krijonte idenë e autoritetit dhe burrërisë tek një njeri. Edhe vjehrra ime abuzonte me mua psikologjikisht edhe verbalisht ndërkohë që unë jetoja me bashkëshortin tim. Ajo ndizte sherret mes meje dhe burrit tim, më kërcënonte me thikë, dhe më gjuante me objekte të forta si dhe ushtronte dhunë verbale”.

Grua, e mbijetuar e dhunës, e moshës 60+

65 “Shefi / mbikëqyrësi”, “kolegu / bashkëpunëtori”, “klient / klient / pacient”, “mësues / trajner /”, “shok-student” doktor/punëtor shëndetësor”, “kushëri/anëtar i familjes (përveç partnerit)”, “kushëri i partnerit / anëtar i familjes së partnerit”, “dikush me të cilin do dilni në takim/ dikush që sapo keni takuar”.


4.5: Përvoja e dhunës gjatë fëmijërisë

Njëzet e gjashtë përqind e grave thonë se kanë përjetuar një formë të dhunës fizike të shkaktuar nga një i rritur që para se ato të mbushnin 15 vjeç⁶⁶, gjë që është e ngjashme me mesataren në BE (27%). Më së shpeshti, ato qëlloheshin në shpullë ose u shkuleshin flokët aq sa u dhimbte (përjetuar nga 24% e të anketuarave, përqindje gjithashtu e ngjashme me mesataren e BE-së prej 22%). Rreth një në tetë (12%) ishin goditur aq fort sa u ka dhembur (Figura 4.7). Prindërit ishin autorët kryesorë të kësaj dhune, si nënat ashtu dhe baballarët në mënyrë të barabartë janë njësoj përgjegjës.

Një dhunë e tillë nuk ka të ngjarë të ketë ndodhur vetëm një herë. Përveç prerjes apo të qëlluarit me thikë, të gjitha format e tjera të dhunës fizike në fëmijëri janë përjetuar më shumë se një herë nga të paktën gjysma e atyre që kishin përjetuar çdo lloj dhune.

Figura 4.7: Përvoja e dhunës para moshës 15 vjeçare

Para se të mbushnit 15 vjeç, sa shpesh ndonjë i rritur, ju ka bërë ndonjë nga të mëposhtmet...



66 Dhuna në fëmijëri i referohet dhunës së ushtruar para moshës 15 vjeçare. Kur flasim për dhunën fizike para moshës 15 vjeçare, grave iu drejtuan këto pyetje: Para se të mbushnit 15 vjeç, sa shpesh një i rritur 18 e sipër ju ka bërë ndonjë nga këto: 1. Ju ka gjuajtur në shpullë apo ju ka shkukur flokët aq sa ju ka dhembur? 2. Ju ka goditur fort aq sa ju ka dhembur? 3. Ju ka gjuajtur në shqelm aq sa ju ka dhembur? 4. Ju ka qëlluar fort me ndonjë objekt si shkopi, bastun apo rrip? 5. Ju ka prerë apo goditur me diçka? Kur flasim për dhunën seksuale para moshës 15 vjeçare, grave iu drejtuan këto pyetje: Para se të mbushnit 15 vjeç, sa shpesh një i rritur 18 e sipër ju ka bërë ndonjë nga këto edhe kur ju nuk keni dashur: 1. Ju kanë treguar organet gjenitale? 2. Ju kanë detyruar të pozoni lakuriq para dikujt apo onë ndonjë foto, video, ose webkamer? 3. Ju ka prekur organet tuaja gjenitale ose gjoksin kundër dëshirës tuaj? 4. Ju ka detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale? Kur flasim për dhunën psikologjike para moshës 15 vjeçare, grave iu drejtuan këto pyetje: Para se të mbushnit 15 vjeç, sa shpesh një i rritur 18 e sipër ju ka bërë ndonjë nga këto: 1. Ju kanë thënë se nuk ju duan? 2. Ju kanë thënë se kanë dashur të mos kishit lindur kurrë? 3. Ju kanë kërcënuar se do t'ju braktisin ose do t'ju nxirrin jashtë nga shtëpia? Para se të mbushnit 15 vjeç, sa shpesh një i rritur 18 e sipër ju ka bërë ndonjë nga këto: Ju ka kërcënuar se do t'ju lëndonte shumë keq fizikisht sa edhe do t'ju vriste? Përhapja e dhunës së fëmijërisë bazohet në të anketuarit të cilët kanë raportuar se kanë përjetuar së paku një nga pikat e lartpërmendura të dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ndonjëherë nga të tria.

Përhapja e dhunës psikologjike në fëmijëri ishte shumë më e ulët (4%). Dhuna seksuale në këtë moshë është edhe më pak e zakonshme, me më pak se 1% të grave që deklarojnë të kenë pasur përvoja. Kjo është shumë më e ulët se mesatarja e BE-së prej 12%, duke filluar nga 1% në Rumani deri në 20% në Francë dhe Holandë. Kroacia kishte një normë prej 2% dhe Bullgaria 3%. Përsëri, vendet ku gratë mendojnë se dhuna në familje është një çështje private dhe ku ekziston një kulturë e heshtjes prirën të kenë përqindje më të ulët të grave që nuk tregojnë se ato kanë pasur përvoja të tilla, krahasuar kjo me vendet me një traditë më të gjatë në rritjen e ndërgjegjësimit për dhunën ndaj grave.

Dhuna gjatë fëmijërisë përjetohet më shpesh nga nxënësit (36%), gratë që përmbushin përgjegjësitë e shtëpisë (41%) dhe gratë që e kanë të vështirë ose shumë të vështirë t'ja dalin me të ardhurat e tyre aktuale (32% dhe 34% respektivisht).

Gratë që kanë përjetuar një formë të dhunës në fëmijëri kanë më shumë gjasa të thonë se kanë përjetuar dhunë fizike dhe / ose seksuale si nga partneri aktual ashtu edhe nga jo partneri: 24% e grave që përjetuan dhunë në fëmijëri thonë se kanë përjetuar dhunë fizike dhe / ose seksuale nga jo partneri, krahasuar me 7% të atyre që nuk kanë përjetuar dhunë në fëmijëri. Për dhunën fizike dhe / ose seksuale të shkaktuar nga partneri intim, shifrat përkatëse janë 35% dhe 14%.

Më shumë se një e katërta e grave thonë se kanë përjetuar dhunë fizike nga ana e një të rrituri para moshës 15 vjeç. Nga këto, 35% përjetuan dhunë fizike nga partneri intim më vonë gjatë jetës së tyre



Pothuajse një e pesta e grave mund të cilësohen si të ndikuara nga konflikti në Shqipëri⁶⁷

5. Konflikti dhe Dhuna

5.1: Eksperienca në lidhje me krizën e vitit 1997

Konflikti i armatosur për qëllimet e këtij studimi është cilësuar si luftë e armatosur midis dy ose më shumë grupeve të organizuara, sulmet ndaj komuniteteve ose pasiguria e përgjithshme e shkaktuar nga konflikti.

Njëzet e një përqind e grave shqiptare thonë se kanë jetuar në një situatë ku ka pasur një konflikt aktiv të armatosur për një periudhë prej së paku një jave. Për shumicën dërrmuese (20.5%), përvoja e tyre personale e konfliktit lidhet me rënien e skemave piramidale dhe luftën civile që pasoi në 1997 dhe 1998 (0.2% treguan se kishin përjetuar konflikte të tjera). Gratë nga veriu dhe gratë nga zonat urbane kanë më shumë gjasa të kenë përjetuar një periudhë konflikti të armatosur siç është cilësuar në këtë studim sesa ato nga rajoni qendror dhe zonat rurale.

Nëse i referohemi atyre që kanë jetuar gjatë kësaj periudhe krize, 91% pohojnë të kenë dëgjuar të shtëna me armë zjarri në zonën rreth tyre dhe 56% jetonin aty ku personeli i armatosur (grupet e rregullta ushtarake apo grupet e tjera të armatosura) ishin të vendosur për të paktën një javë. Pesëdhjetë e një përqind e panë nga afër luftën në vendin ku jetonin. Njëzet përqind e grave pohuan se pronat e tyre qenë shkatërruar ose dëmtuar rëndë, 12% të tyre i ishin rrëmbyer pronat nga grupet e armatosura, 48% e tyre nuk kishin mundur të gjenin një punë ndërsa 8% kishin ikur nga shtëpia, të cilat më vonë mundën të ktheheshin në shtëpi.

Në përgjithësi, 19% e grave mund të konsiderohen drejtpërdrejt të ndikuara nga konflikti, që do të thotë se ato kanë përjetuar një periudhë konflikti ose krize dhe kanë përjetuar të paktën një nga eksperiencat e lidhura me konfliktin e diskutuar më sipër.

Ato që u përcaktuan si të ndikuara drejtpërdrejt nga konflikti, u pyetën edhe për pasojat e tjera që të jetuarit në kohë konflikti sillte, nga mungesa e shërbimeve publike deri te humbja e anëtarëve të familjes dhe përvojat e dhunës.

Shtatëdhjetë e tre përqind kanë përjetuar të paktën një nga përvojat e renditura në Tabelën 5.1. Dyzet e nëntë përqind ishin pa shërbime shëndetësore apo pa zbatim të ligjit për një periudhë të gjatë kohe. Siç u diskutua në kapitullin 5, kur ato u pyetën se përse nuk e kishin raportuar incidentin më të rëndë të dhunës të shkaktuar nga jo partneri në polici, 7% thanë se nuk kishin mundur ta bënin këtë për shkak të konflikteve / krizave të armatosura. Një në dhjetë gra thanë se gratë në zonën e tyre i ishin nënshtruar praktikave thellësisht poshtëruese nga pjesëtarët e grupeve të armatosura dhe 6% kanë pasur një anëtar të afërm të familjes ose partnerin të lënduar ose të vrarë për shkak të luftimeve.

67 Përkufizimi i "ndikuar nga konflikti" nënkupton që personi ka jetuar aty ku ka pasur një konflikt të armatosur aktiv prej të paktën një jave dhe nëse personi i përgjigjet me "po" të paktën njëherë nga pyetjet e mëposhtme: "A keni dëgjuar të shtëna me armë, bomba apo mina në zonën ku ju banonit në kohën e konfliktit?" "Keni jetuar të paktën për një javë në të njëjtin vend ku personeli i armatosur (grupe ushtarake ose grupe të armatosura) të shumtë në numër?" "Keni qënë dëshmitare e luftimeve në zonën ku ju banonit në kohën e konfliktit?" "Prona juaj (psh. shtëpia, makina, gjëja e gjallë) apo e ndonjë të afërmi tuaj është shkatërruar apo dëmtuar rëndë? Prona juaj (psh. shtëpia, makina, gjëja e gjallë) apo e ndonjë të afërmi tuaj është marrë me dhunë nga grupet e armatosura?" "A ishte e pamundur të gjenit punë në zonën ku ju banonit për shkak të konfliktit (zyrat / fabrikat ishin mbyllur apo shkatërruar, a ishte shumë e rrezikshme)?" "A mori pjesë në konflikt një pjesëtar i afërm i familjes suaj apo bashkëshorti /apo luftuan si anëtarë të një grupi të armatosur?" "A keni luajtur një rol aktiv në luftimet gjatë konfliktit?" "A u vranë civilë në zonën ku jetoni, për shkak të konfliktit?" "A jeni sulmuar fizikisht ose lënduar për shkak të konfliktit?" "A keni ikur nga shtëpia juaj gjatë konfliktit (konflikteve) që keni përjetuar?"

Tabela 5.1: Eksperiencat e grave të ndikuara drejtpërdrejt nga konflikti

Ju lutem më thoni nëse keni përjetuar ose jo ndonjë nga të mëposhtmet gjatë konflikteve të armatosura.

	Po %
Shërbimet shëndetësore (përfshirë këtu shërbimet shëndetësore për gratë) që ju më herët i përdornit që ose nuk ofroheshin më ose ishin të pa aksesueshme për një periudhë të gjatë kohe.	52
Nuk kishte asnjë forcë (policia apo ndonjë organizatë tjetër që të ruante rendin dhe qetësinë) të pranishme në zonën tuaj për një kohë të gjatë.	49
Grupe të armatosura që me qëllim përdornin kërcënimet, fjalët apo akte të dhunshme ndaj grave për të terrorizuar popullsinë në zonën ku ju banonit	12
Anëtarë të grupeve të armatosura ngacmonin gratë e zonës ku ju banonit	12
Anëtarë të grupeve të armatosura kishin praktika tejmase poshtëruese ndaj grave të zonës ku ju banonit, si për shembull, detyronin gratë të dilnin zhveshur në publik, duke gjymtuar trupat e tyre, i kontrollonin për substanca të ndryshme në brendësi të pjesëve të tyre intime pa asnjë arsye, etj.)	10
Rrethanat i detyronin gratë që të ofronin favore seksuale në shkëmbim të të mirave bazë apo për të garantuar sigurinë e familjes së tyre në zonën ku ju banonit.	8
Burrat e familjes suaj (bashkëshortë, baballarë, vëllezër) ishin larg shtëpisë dhe familjes, (sepse duhet të linin vendin, të luftonin gjatë konfliktit, u arrestuan, humbën)	7
Grave në familjen tuaj ju desh të shkonin në vende potencialisht të rrezikshme (psh. Në vijën e parë të luftimeve/ në kufi/ose afër eksplozive si psh minat) kur shkonin në punë ose të merrnin gjërat bazë që i duheshin për shtëpinë (dru për zjarr, ushqime, ujë të pijshëm, karburant etj.)	7
Ndonjë i afërm i familjes suaj, bashkëshorti ose bashkëshortja u lënduan, vdiqën si pasojë e luftimeve apo dhunës?	6

BAZA: 386 gra nga moshë 18–74 në Shqipëri të cilat janë prekur nga konflikti me armë
BURIMI: OSBE-ka bërë një studim mbi dhunën ndaj grave (2018)

5.2: Konflikti ose kriza dhe dhuna ndaj grave

Ekzistonte një farë perceptimi tek gratë pjesëmarrëse në studimin cilësor që dhuna ndaj grave ishte gjithmonë e zakonshme në Shqipëri, por që u përkeqësua gjatë tranzicionit të regjimit dhe krizës politike dhe ekonomike të vitit 1997. Gratë mendonin se gjatë periudhës së komunizmit njerëzit kishin më shumë frikë nga shteti dhe se kjo nënkuptonte se kishte më pak krim, përfshirë dhunën ndaj grave, ndaj normat ishin më të ulëta. Ato thanë se, gjatë periudhës së tranzicionit, kishte paqëndrueshmëri në rend dhe ligj dhe se kjo ndikoi që njerëzit të vetë armatoseshin dhe t'i përdornin këto armë zjarri ndaj grave. Është vënë re se këto ndryshime kanë çuar në një rritje të dhunës së shkaktuar nga partneri intim, si dhe në çështje më të gjera si trafikimi dhe prostitucioni i detyruar i grave dhe vajzave.

Gratë e ndikuara drejtpërdrejt nga konflikti u pyetën nëse ndonjë nga përvojat e tyre të dhunës kishte qenë lidhur me një konflikt / krizë të armatosur. Ndër ato që tregojnë se përjetojnë dhunë fizike dhe / ose seksuale të shkaktuar nga jo partneri, 26% thonë se ky ishte rasti, duke u rritur në 44%⁶⁸ kur u pyetën për incidentin më serioz të dhunës fizike dhe / ose seksuale që ato kishin përjetuar.

68 Këtu duhet të zbatohet kujdes për shkak të bazës së ulët (42)

Një model i ngjashëm është parë edhe me dhunën e shkaktuar nga partneri aktual, me 46%⁶⁹ të grave që lidhin çdo përvojë me një konflikt / krizë të armatosur, e cila vjen në rritje me 66%⁷⁰ kur bëhet fjalë për incidentin më të rëndë të dhunës fizike / seksuale. Në lidhje me përndjekjen, shifrat janë përkatësisht 33% dhe 36%. Shifra është shumë më e ulët kur vjen puna te ngacmimi seksual, 4% e grave e lidhin incidentin më të rëndë me një konflikt / krizë të armatosur. E njëjta përqindje e grave (4%) pohojnë se përvojat e tyre të fëmijërisë në lidhje me dhunën kanë ndodhur në periudhën e një konflikti / krize të armatosur.

Krahas përmasave të konsiderueshme të grave të ndikuara drejtpërdrejt nga konflikti që lidhin përvojat e tyre të dhunës me konfliktin / krizën, shtrirja e disa llojeve të dhunës është më e lartë midis atyre që janë cilësuar si të ndikuara drejtpërdrejt nga konflikti.

- Njëzet e shtatë përqind e grave të ndikuara drejtpërdrejt nga konflikti deklarojnë se kanë përjetuar dhunë fizike në një moment të caktuar nga partneri aktual krahasuar me 14% të grave që nuk janë ndikuar nga konflikti. Sa i përket dhunës në 12 muajt para studimit, shifrat janë përkatësisht 16% dhe 5%.
- Shtatë përqind e grave të ndikuara drejtpërdrejt nga konflikti thonë se kanë përjetuar dhunë seksuale në një moment të caktuar nga partneri aktual, kundrejt 1% të grave që nuk janë ndikuar nga konflikti. I njëjti model shihet gjatë 12 muajve para studimit (5% kundrejt 1%).
- Tridhjetë përqind e grave të ndikuara drejtpërdrejt nga konflikti thonë se kanë përjetuar dhunë fizike nga partneri i mëparshëm krahasuar me 19% të atyre që nuk kanë qenë të ndikuara nga konflikti. Shifrat janë përkatësisht 8% dhe 2% në 12 muajt para studimit.
- Gratë e ndikuara drejtpërdrejt nga konflikti kanë tri herë më shumë gjasa të thonë se kanë përjetuar dhunë psikologjike në fëmijëri (9% kundrejt 3%).

Gratë e ndikuara drejtpërdrejt nga konflikti dhe që kanë përjetuar dhunë qoftë nga partneri apo nga jo partneri kanë më shumë gjasa të tregojnë se incidenti më serioz ka ndikuar psikologjik mbi to: 80% pohojnë se kanë përjetuar një ose më shumë ndikime psikologjikut, në krahasim me 63% të atyre që nuk janë prekur nga konflikti. Në veçanti, gratë e ndikuara nga konflikti kanë dy herë më shumë gjasa të thonë se kanë përjetuar depresion (34% kundrejt 16% të atyre që nuk janë të ndikuara nga konflikti), humbje të vetëbesimit (28% kundrejt 15%), vështirësi në marrëdhënie (26% kundrejt 14%), dhe ato kanë më shumë gjasa të pohojnë se kanë hasur vështirësi në gjumë (34% kundrejt 19%).

Lëndimet fizike si pasojë e incidentit më të rëndë të shkaktuar nga partneri ose jo partneri ishin gjithashtu më të zakonshme kryesisht midis grave drejtpërdrejt të ndikuara nga konflikti; 44% thonë se nuk kanë pasur ndonjë dëmtim, ndërsa 57% e atyre që nuk janë të ndikuara nga konflikti thonë të njëjtën gjë.

Ndër gratë që kanë jetuar një periudhë konflikti të armatosur dhe që sot vuajnë nga një sëmundje apo paaftësi, 4% konsiderojnë konfliktin shkak të gjendjes së tyre.

Përqindja e grave në përgjithësi që thonë se janë sulmuar ose kërcënuar me armë zjarri është shumë e ulët dhe të dhënat duhet të trajtohen me kujdesin e duhur. Më pak se 1% e grave janë sulmuar dhe vetëm nën 1% janë kërcënuar. Kjo përfshiu 25% të të anketuarave, shumica e të cilave e përjetuan këtë ngjarje më shumë se një vit përpara studimit. Ndër ato që kanë përjetuar dhunë të shkaktuar nga partneri ose jo partneri, 3% thonë se ato janë sulmuar ose kërcënuar me armë zjarri (gjithsej 14 të anketuara).

Gratë që morën pjesë në studimet cilësore thanë se gjatë periudhës së tranzicionit dhe krizës ekonomike dhe politike të vitit 1997, një numër i madh i njerëzve morën armë zjarri duke nënkuptuar që u rrit numri i grave që shpesh vriteshin nga partnerët e tyre edhe për konflikte të vogla midis çiftit.

69 Këtu duhet të zbatohet kujdes për shkak të bazës së ulët (55)


70 Këtu duhet të zbatohet kujdes për shkak të bazës së ulët (50 dhe 42)



Më shumë se gjashtë në dhjetë të mbijetuara të dhunës fizike dhe/ose seksuale të shkaktuar nga partneri ose jo partneri thonë se kanë vuajtur nga të paktën një prej një sërë reagimesh psikologjike si pasojë e incidentit më serioz. Incidenti më serioz është cilësuar incidenti që pati ndikimin më të madh si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht tek gratë e anketuara.



Më shumë se katër në dhjetë gra që identifikuan incidentin më të rëndë të dhunës fizike dhe/ose seksuale të shkaktuar nga partneri intim ose jo partneri, pësuan një ose më shumë lëndime fizike si rezultat i incidentit.



Vetëm 3% e grave të cilat kanë përjetuar dhunë të shkaktuar nga partneri aktual kanë kontaktuar policinë pas ndodhjes së incidentit më serioz.

6. Impakti i dhunës në jetët e grave dhe barrierat e të kërkuarit ndihmë


Ky kapitull ofron një pasqyrë të ndikimit që dhuna ka pasur në mirëqenien e grave, si dhe informacionin nëse ato kanë raportuar përvojat e tyre të dikush, dhe nëse e kanë bërë, sa të kënaqura kanë mbetur me përgjigjen. Gjatë intervistave, gratë u pyetën mbi ndikimin që incidenti më serioz i dhunës fizike ose seksuale apo të dyja kishin pasur tek ato. Incidenti më serioz u cilësua ai që kishte pasur më shumë ndikim të gruaja, psikologjikisht apo fizikisht.

6.1: Reagimet psikologjike dhe lëndimet fizike

Pothuajse të gjitha gratë që kanë ndarë përvojat e tyre mbi dhunën fizike ose seksuale kanë përjetuar të paktën një nga ndjesitë e paraqitura në Tabelën 6.1. Gratë që kishin përjetuar dhunë të shkaktuar nga partnerët aktualë, kishin më shumë gjasa të kishin ndjerë zemërim dhe mërzë pas ndodhjes së incidentit më serioz. Këto janë gjithashtu reagimet emocionale më shpesh të përmendura kur bëhet fjalë për incidentin më të rëndë të dhunës të shkaktuar nga partneri i mëparshëm, tronditje dhe frikë, secila e përmendur nga rreth gjysma e të anketuarave. Frika, mërzia dhe zemërimi përmenden nga katër në dhjetë të anketuara në lidhje me incidentin më të rëndë të dhunës të shkaktuar nga jo partneri. Këto tre përgjigje janë më të zakonshmet edhe në BE.

Tabela 6.1 Reagime emocionale si pasojë e dhunës fizike dhe/ose seksuale (incidenti më serioz)

Duke menduar për incidentin më serioz, a keni pasur ndonjë nga këto ndjesitë në vijim si rezultat?



	Partneri aktual	Partneri i mëparshëm	Jo partner
	%	%	%
Mërzi	56	64	40
Zemërim	53	62	42
Shokim	22	55	26
Turpërim	20	25	16
Agresivitet	20	33	14
Frikë	20	45	44
Siklet	18	33	13
Faj	11	13	8
Asnjë nga të mësipërmet	4	3	11

BAZA:
Gra në Shqipëri nga grupmosha 18–74 vjeç të cilat kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale që në moshën 15 vjeçare dhe që cilësuan si ngjarjen më të rëndë atë të shkaktuar nga partneri aktual (200), partneri i mëparshëm (68) ose nga jo partneri (148)

BURIMI:
OSBE-ka bërë një studim mbi dhunën ndaj grave (2018)


Emocione të ngjashme dolën edhe nga ngacmimet seksuale. Pothuajse të gjitha gratë që treguan se e kanë përjetuar ngacmimin seksual pohuan të kenë ndjerë të paktën një nga emocionet në Tabelën 6.1. Ndërkohë që ndjesia e frikës u dha më pak si përgjigje cilësuese kur bëhej fjalë për incidentin më serioz të ngacmimit, pothuajse gjysma e të anketuarave u ndjenë të turpëruara (44%) ndërsa 38% të zemëruara.

Reagimet psikologjike afatgjata të renditura në Tabelën 6.2 u përjetuan nga 84% e grave kur bëhej fjalë për incidentin më serioz të dhunës së shkaktuar nga partneri i mëparshëm. Më të pakta janë ato gra që deklarojnë të njëjtën gjë kur vjen puna tek dhuna e shkaktuar nga partneri aktual (61%) si dhe ato që deklarojnë dhunën e shkaktuar nga jo partneri (62%).

Ndikimet më të zakonshme psikologjike që kanë ardhur si pasojë e incidentit më serioz të dhunës së shkaktuar nga partneri i mëparshëm janë vështirësia në të fjetur (46%) dhe ankthi (45%), si edhe disa të tjera që tre gra nga dhjetë i kanë përmendur, përfshirë këtu vështirësitë në përqendrim (35%) vështirësi në marrëdhënie me të tjerët (33%), humbje e vetëbesimit (34%) dhe depresioni (29%). Vështirësia në të fjetur dhe ankthi përmenden gjithashtu më shpesh kur flitet për incidentin më serioz të dhunës së shkaktuar nga partneri aktual, megjithëse me përmasa më të vogla (përkatësisht 26% dhe 20%). Depresioni (21%) dhe krizat e panikut (18%) kanë më shumë gjasa të përjetojnë pas dhunës së shkaktuar nga jo partneri. Ankthi, depresioni dhe dobësia ishin reagimet më së shumti të përmendura në BE.

Tabela 6.2: Pasojat psikologjike ndaj dhunës fizike dhe / ose seksuale (incidenti më i rëndë)

Duke menduar për incidentin më të rëndë, a keni vuajtur nga ndonjë nga këto më poshtë si rezultat?



Ngacmimi seksual nuk ka shkaktuar në të njëjtën masë reagime psikologjike si dhuna fizike apo seksuale. Tre të pestat e grave të anketuara pohuan se ngacmimi seksual nuk ka pasur një ndikim afatgjatë psikologjik ndaj incidentit më serioz. Megjithatë, rreth një në dhjetë gra ndihen të pambrojtura (11%), të shqetësuara (10%) ose kanë përjetuar humbje të vetëbesimit (gjithashtu 10%).

Gratë pjesëmarrëse në studimin cilësor që kishin përjetuar dhunë përshkruan një gamë të gjerë të ndikimeve fizike dhe psikologjike që kjo e fundit kishte shkaktuar. Dhuna fizike ose seksuale mund të rezultojë në ndikime të menjëhershme fizike, duke përfshirë plagë ose plagosje serioze, osë plagë më të rënda si plagë të shkaktuara me thikë. Disa gra thanë se kishin pasur nevojë për kujdes urgjent mjekësor pas sulmit.


6. Impakti i dhunës në jetët e grave dhe barrierat e të kërkuarit ndihmë

Gratë që morën pjesë në studimin cilësor treguan se pasojat psikologjike kishin ndikim më të madh sesa ato fizike. Ato shpjeguan se përvojat e tyre të dhunës i kishin bërë të ndiheshin më të izoluar dhe, si rezultat i sjelljes kontrolluese të partnerit të tyre, shpesh nuk ju lejohej të takonin miqtë ose anëtarët e familjes dhe rrjedhimisht nuk kishin mbështetje emocionale. Një grua përshkroi se si githë ato vite abuzimi e kishin bërë atë të ndihej e depresuar dhe agresive. Ajo shpegoi gjithashtu se këto ndjesi e kishin bërë atë të vetë lëndohej apo edhe të tentonte vetvrasje.

Një model i ngjashëm mund të shihet në studim, ku më pak gra deklarojnë se vuajnë nga një lëndim fizik apo pasojë e tij, në krahasim me vuajtjen nga ndikimi emocional ose psikologjik që incidenti më i rëndë i dhunës nga partneri aktual u ka shkaktuar. Sidoqoftë, përqindja e grave që thonë se kanë pësuar një dëmtim fizik është ende e rëndësishme, kjo vihet re më së shumti në lidhje me incidentet më serioze të dhunës së shkaktuar nga partneri i mëparshëm (58%) nga jo partneri (48%) se sa në lidhje me dhunën e shkaktuar nga partneri aktual (28%). Më së shumti gjejmë të përmendura të nxirat dhe gërvishtjet (Tabela 6.3).

Tabela 6.3: Lëndimet fizike që vijnë si pasojë e dhunës fizike dhe / ose seksuale (incidenti më i rëndë)

Duke menduar për incidentin më të rëndë, a ka rezultuar në ndonjë nga këto më poshtë?



	Partneri aktual	Partneri i mëparshëm	Jo partner
	%	%	%
Të nxira, gërvishtje	24	56	26
Dëmtime të brendshme	5	9	1
Plagë, ndrydhje, të djegura	4	14	10
Fraktura, kocka të thyera, dhëmbë të thyer	3	3	7
Tronditje ose dëmtime të tjera në tru	3	9	13
Infeksion ose sëmundje seksualisht të transmetueshme	1	1	0
Dështim të barrës	0.4	1	0
Sterilitet ose pamundësi për ta vazhduar shtatëzaninë (gjithashtu nëse ndodhi për shkak të një aborti të bërë jo si duhet)	0	0	1
Shtatëzani	0	3	0
Asnjë dëmtim	70	41	44

BAZA:
Gra në Shqipëri nga gruomosha 18–74 të cilat kanë përjetuar dhunë që në moshën 15 vjeçare dhe që cilësuan si ngjarjen më të rëndë atë të shkaktuar nga partneri aktual (200), partneri mëparshëm (68) ose nga jo partneri (148)

BURIMI:
OSBE-ka bërë një studim mbi dhunën ndaj grave (2018)


6.2: Mbështetja që duan të mbijetuarat e dhunës

Të anketuarat që kishin përjetuar dhunë fizike dhe / ose seksuale u pyetën nëse kishin nevojë për ndihmë pas incidentit më të rëndë që kishin përjetuar.

Burimi më i përmendur i informacioneve, këshillave apo mbështetjes që gratë thonë se donin pas incidentit më serioz të dhunës fizike dhe / ose seksuale të shkaktuar nga partneri, si në Shqipëri dhe në BE, ishte dikush me të cilin të bisedonin, dikush që mund t'u ofronte mbështetje morale. Informacioni nga policia, ndihma praktike dhe mbrojtja nga viktimizimi / ngacmimi i mëtejshëm u kërkuar edhe nga një e pesta e të mbijetuarave të dhunës së shkaktuar nga partnerët e mëparshëm (Tabela 6.4).

Tabela 6.4: Lloji i informacionit, këshillave dhe mbështetjes të kërkuar pas një incidenti

Çfarë llojesh informacioni, këshillash ose mbështetje do të donit pas incidentit më serioz që keni përjetuar?



	Partneri aktual	Partneri I mëparshëm	Jo partner
	%	%	%
Dikë me të cilin/cilën të flisja/ mbështetje morale	33	49	25
Mbrojtje e mëtejshme nga viktimizimi/ngacmimi	10	18	15
Ndihmë konkrete	9	20	11
Informacion nga policia	9	21	10
Informacion mbi sigurinë/parandalimin e krimit	7	16	12
Mbështetje financiare	7	12	4
Ndihmë mjekësore	4	13	13
Ndihmë për raportimin e ngjarjes/ kur ke të bësh me policinë	3	8	9
Ndihmë me siguracionet/ kërkesë për kompensim	2	17	2
Asnjë nga këto/ nuk doja asnjë mbështetje	48	33	30

BAZA:
Gra në Shqipëri nga grupmosha 18–74 të cilat kanë përjetuar dhunë që në moshën 15 vjeçare dhe që cilësuan si incidentin më të rëndë atë të shkaktuar nga partneri aktual (200), partneri mëparshëm (68) ose nga jo partneri (148))

BURIMI:
OSBE-ka bërë një studim mbi dhunën ndaj grave (2018)


Lloji i përkrahjes që gratë dëshirojnë pas ndodhjes së episodit të dhunës u diskutua më hollësisht gjatë intervistave të gjata. Një nga nevojat kryesore të paplotësuara për gratë që kishin përjetuar dhunë nga partneri intim ishte mbështetje psikologjike. Disa gra iu referuan një psikologu përmes policisë ose gjykatave. Të tjerave, policia u kishte referuar një OJQ, e cila i ka ndihmuar ato të kenë akses juridik, si dhe këshillim. Një grua e kishin drejtuar për të marrë konsulta falas tek një psikolog, ndërkohë që psikologu më pas i kërkoj asaj të paguante për seancën. Gratë nuk ishin në dijeni të shërbimeve të tjera që mund t'u ofroheshin atyre në mënyrë të pavarur. Kjo do të thotë se gratë që nuk do t'i raportojnë përvojat e tyre ose ato që raportojnë përvojat e tyre tek një profesionist jo fort i kuptueshëm dhe i ditur, nuk kishin gjasa të merrnin mbështetjen që u duhej.

6. Impakti i dhunës në jetët e grave dhe barrierat e të kërkuarit ndihmë

Më pak se gjysma e grave thonë se ndihen mirë ose shumë mirë të informuara se çfarë duhet të bëjnë nëse përjetojnë dhunë (46%), ndërsa 28% thonë se nuk ndihen të mirë informuara ose nuk e dinë fare se çfarë duhet të bëjnë.

Figura 6.1: Ndërgjegjësimi se çfarë duhet bërë pas përjetimit të dhunës

Sa të mirë informuar jeni në lidhje se me atë se çfarë duhet të bëni nëse përjetoni dhunë?



Gratë mbi 60 vjeç kanë më shumë gjasa se mesatarja të thonë se ato nuk ndihen të mirë informuara ose nuk dinë se çfarë të bëjnë (37%), sikundër edhe ato që nuk kanë arsim formal apo fillor (42%) dhe ato që jetojnë në zonat rurale (35%).

Në këtë studim, gratë u pyetën nëse kishin dëgjuar mbi tre organizatat që ofrojnë mbështetje për viktimat e dhunës. Ndërgjegjësimi i Linjës së Këshillimit për Vajzat dhe Gratë ishte më i lartë, me 65% të grave që kishin dëgjuar për të. Rreth dy të pestat kishin dëgjuar për Qendrën e Aleancës Gjimore për Zhvillim (GADC) (44%) dhe Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) (41%). Ndërgjegjësimi mbi këto tre organizata është më i ulët tek gratë mbi 60 vjeç, gratë me arsim fillor dhe gratë që merren vetëm me kryerjen e detyrimeve mbi shtëpinë, dhe është më e lartë midis grave që kanë arsim të lartë dhe grave të punësuar. Ndërgjegjësimi i GADC është veçanërisht i lartë në mesin e 18-29-vjeçarëve (50%), ndërsa QNL nuk është aq i njohur në rajonin qendror të vendit (35%). Ndërgjegjësimi i Linjës së Këshillimit për Vajzat dhe Gratë është më i lartë në zonat urbane sesa në zonat rurale (72% kundrejt 57%).

Ndërsa mbi dy të tretat e grave kanë dëgjuar për të paktën një nga këto organizata, gjithsesi ato në përgjithësi nuk janë telefonata e parë që gruaja bën pas përjetimit të incidentit të dhunës ose ngacmimit seksual, pavarësisht nga dhunuesi, siç është diskutuar në seksionin 6.3.

Gjashtëdhjetë e gjashtë përqind kanë parë fushata për dhunën ndaj grave, ndërgjegjësim të lartë ka veçanërisht në mesin e grave me arsim të lartë (78%) atyre që paguhen për punën që bëjnë (77%), ndërsa gratë me arsim fillor (57%), gratë që jetojnë në zonat rurale (60%) dhe gratë që janë në pension (57%), kanë më pak gjasa të sjellin ndërmend fushata të tilla.


6.3: Përvojat me raportimin e dhunës dhe ngacmimeve

Në studim, gratë u pyetën nëse policia apo organizata të tjera ishin të informuar në lidhje me incidentin e tyre më serioz të dhunës fizike ose seksuale, përfshirë kërcënimet e dhunës fizike dhe seksuale.

Edhe pas incidenteve më serioze të dhunës fizike dhe / ose seksuale, policia nuk ishte e informuar për incidentin më serioz në shumicën e rasteve, siç shihet edhe në Figurën 6.2 më poshtë.

Figura 6.2: Kontaktimi me policinë pas incidentit më serioz të dhunës fizike dhe / ose seksuale

E mori vesh policia për incidentin [më serioz]?



Gratë kishin prirje të mos kontaktonin me shërbimet e tjera. Në lidhje me dhunën e shkaktuar nga partneri aktual, pothuajse nëntë në dhjetë që kishin përjetuar incidentin më serioz nuk kishin kontaktuar me policinë apo me ndonjë organizatë tjetër (87%) dhe e njëjta gjë vlen edhe për shtatë në dhjetë raste të incidenteve më serioze të partnerit të mëparshëm (70 %) dhe gjashtë në dhjetë për dhunë nga jo partneri (61%) (Tabela 6.5).

Tabela 6.5 Kontakti pas incidentit më serioz të dhunës fizike dhe/ose seksuale

A kontaktuat ndonjë nga shërbimet e mëposhtme si rezultat të incidentit më të rëndë?

	Partneri aktual %	Partneri i mëparshëm %	Jo partner %
Policinë (vetë raportim)	3	16	17
Spitalin	7	18	10
Doktorin, qendrën shëndetësore ose ndonjë institucion tjetër shëndetësor	6	18	14
Strehëzën për gratë	1	3	0
Ndonjë shërbim/organizatë tjetër	1	3	0.4
Kishë/Organizatë të ndonjë besimi fetar	1	2	6
Shërbim ligjor/avokat	0.4	14	7
Shërbimin social	0.4	4	0
Organizatën e mbështetjes së viktimave	0	3	0
Asnjë organizatë apo polici e kontaktuar	87	70	61

BAZA: Gra në Shqipëri nga grupmosha 18-74 të cilat kanë përjetuar dhunë që në moshën 15 vjeçare dhe që cilësuan si incidentin më të rëndë atë të shkaktuar nga partneri aktual (200), partneri mëparshëm (68) ose nga jo partneri (148)

BURIMI: OSBE-ka bërë një studim mbi dhunën ndaj grave (2018)

6. Impakti i dhunës në jetët e grave dhe barrierat e të kërkuarit ndihmë

Arsyeja kryesore për mos raportimin e incidentit më serioz të dhunës në polici është se viktimat vendosën të merren vetë me të, ose ndoshta duke përfshirë miqtë dhe familjen, ndërsa në veçanti, në rastin kur dhuna shkaktohej nga partneri aktual, ato e konsideronin atë një çështje shumë të parëndësishme. Arsye tjetër është edhe fakti që ato e kanë të vështër të shohin partnerin e tyre tek arrestohet, apo kanë dashur ta mbajnë private çështjen, mund të kenë pasur frikë nga dhunuesi, siç tregohet edhe në Tabelën 6.6 më poshtë.

Tabela 6.6 Arsytet përse viktimat nuk kanë kontaktuar me policinë

Përse nuk kontaktuat me policinë?



	Partneri aktual	Partneri i mëparshëm	Jo partneri
	%	%	%
Arrita që ta zgjidhja vetë / përfshiva një shok ose shoqe / çështje familjare	43	43	43
Ishte diçka tepër e vogël / jo shumë serioze / nuk më kishte ndodhur kurrë	41	13	16
Nuk doja që partneri/dhunuesi të arrestohej apo të ishte në telashe me policinë	11	12	1
Nuk doja ta merrte vesh njeri/e mbajta private	8	19	11
Kisha turp, siklet	5	6	2
Frikë nga partneri/dhunuesi	5	11	5
Nuk doja që marrëdhënia të përfundonte	5	4	0
Nuk besova se dikush mund të ndihmonte	3	0	7
Shumë e shqetësuar emocionalisht	3	6	4
Kisha frikë se do të humbisja fëmijët	3	3	0
Dikush më ndaloi ose dekurajoi	2	2	1
Nuk do të më besonin	1	0	1
Nuk mundeova se dikush mund të bënte diçka	1	9	0
Mendova se ishte gabimi im	1	3	0
Nuk me lejoi partneri	1	0	0
Shkova diku tjetër për ndihmë	1	3	0
Kisha frikën e hakmarrjes nga një person tjetër jo partner	1	0	1
Dikush tjetër e raportoi, ose policia e kishte	1	0	0
Nuk e kontaktova dot policinë për shkak të konfliktit	0	0	7

BAZA:
Gra në Shqipëri nga grupmosha 18–74 të cilat kanë përjetuar dhunë që në moshën 15 vjeçare dhe që cilësuan si incidentin më të rëndë atë të shkaktuar nga partneri aktual (200), partneri mëparshëm (68) ose nga jo partneri (148)

BURIMI:
OSBE-ka bërë një studim mbi dhunën ndaj grave (2018)

Arsyet e dhëna për mos kontaktimin e shërbimeve të tjera janë të ngjashme me ato të dhëna për mos kontaktimin e policisë (Tabela 6.6). Vendimi për t'u marrë me vetë incidentin është arsyeja më e shpeshtë për mos kontaktimin e policisë apo shërbimeve të tjera (si në BE).

Siç u diskutua edhe në kapitullin 3, studimi sasior evidentoi faktin se gati gjysma e grave në Shqipëri janë të mendimit se dhuna në familje duhet të mbahet brenda familjes.

Pengesat që u hasën në raportim u diskutuan në detaje në studimin cilësor. Gratë që morën pjesë u shprehën se ishin të mendimit se përgjigja e parë e çdo gruaje në Shqipëri që përjetonte dhunë do të ishte: dhuna duhet duruar. Pas kësaj, nëse dhuna do të vazhdonte, gratë thanë se personi i parë me të cilin një grua e dhunuar do të fliste do të ishte dikush që ato mendonin se nuk do t'i gjykonte, si një mik apo një motër.

Disa mendonin se një mik i tyre ose pjesëtar i familjes mund edhe t'i inkurajonte ato që të ndryshonin sjellje, si për shembull të folurit më me butësi me bashkëshortin e tyre në mënyrë që të mund të parandalohet konflikti i ardhshëm. Gratë thanë se viktimat shpesh inkurajoheshin për ta provuar sërish apo që t'u jepnin partnerëve një shans të dytë.

Shtatëdhjetë e gjashtë përqind e grave mendojnë se do të ishte mirë që mjekët të pyesnin më tepër gratë që kanë shenja lëndimesh të caktuara nëse ato u janë shkaktuar nga dhuna.

Pengesat e mësipërme, të identifikuar në studimin cilësor, mund të ndikojnë tek fakti që gratë duan të merren vetë me zgjidhjen e incidenteve të dhunës.

Kutia 6.1 Pengesat për raportimin e identifikuar në hulumtimin cilësor përfshijnë:

1. **Turpin:** frika e gjykimit nga familja dhe komuniteti i tyre.
2. **Mungesa e ndërgjegjësimit ndaj shërbimeve të specializuara:** shumë gra nuk e dinin se ku duhej të drejtohehin, përveç shërbimeve formale shëndetësore dhe policore, ku mund të merrnin ndihmë.
3. **Mungesa e besimit në institucione:** shumë gra shprehën besimin se policia do të ishte indiferente ndaj DHPI dhe që nuk do t'i siguronte mbështetje të përshtatshme.
4. **Frika nga pasojat:** shumë gra thanë se kishin frikë se dhuna fizike do të përshkallëzohej pas raportimit të dhunës.

Një nga pengesat kryesore për të raportuar dhunën e identifikuar në studimin cilësor ishte turpi. Shumë nga gratë që morën pjesë, shprehën mendimin se shumica e njerëzve do të mendonin se një grua duhet të kishte bërë patjetër diçka për ta merituar dhunën që kishte përjetuar. Gratë thanë se shumica e komuniteteve do të ishin indiferente ndaj dhunës dhe se gratë që përjetonin dhunë do të shqetësoheshin për atë që do të mendonin miqtë, familja, kolegët dhe komuniteti. Ato gjithashtu thanë se shumë gra nuk donin të raportonin dhunën, sepse ky raportim do të shihej si një hap drejt divorcit, të cilin ato gjithashtu e konsideronin një veprim të turpshëm.

6. Impakti i dhunës në jetët e grave dhe barrierat e të kërkuarit ndihmë

Meqenëse shumë gra besojnë se shoqëria e sheh dhunën si një pjesë normale të martesës, ato shprehën mendimin se familja dhe miqtë e një gruaje do ta kritikonin atë nëse ajo do ta linte partnerin e saj për shkak të dhunës. Gratë thanë se edhe familjet që donin ta mirëprisnin sërish vajzën e tyre në shtëpi, përsëri mund të shqetësoheshin për atë që komuniteti do të thoshte, veçanërisht komunitetet më të vogla. Në disa komunitete, gratë thanë që nëse një grua kthehej në familjen e saj të lindjes menjëherë pas martese, do të hamendësohej se ajo nuk ka qenë e virgjër kur u martua, ndaj dhe i është dashur të kthehet.

“Fillimisht unë nuk doja që t’ia tregoja prindërve të mi, sepse nuk doja që t’i mërzisja. Kisha vetëm një muaj që isha martuar dhe kisha frikë se nëse kthehesha njerëzit do të mendonin se unë nuk kisha qenë e virgjër dhe se kjo ishte arsyeja që unë u ktheva sërish tek shtëpia e babait tim. Dhuna vazhdoi dhe mua m’u desh të flisja rreth abuzimit më familjen time, babai im nuk donte që unë të shkoja në polici të raportoja dhunën sepse atij i vinte turp se çfarë do të mendonte komuniteti për familjen tonë. Ai donte ta zgjidhte problemin midis dy familjeve”

Grua, e mbijetuar e dhunës, moshë 18-49

“Këtu njerëzit thonë: “Po hë tani, si munda ta denonconte të shoqin në polici? Është bashkëshorti i saj. Burrë është fundja. Nuk i erdhi turp? Ka tre fëmijë!”

Grua, moshë 19-40 rrome

Ekziston gjithashtu një ndjesi shumë e theksuar turpi kur bëhet fjalë për të raportuar dhunën seksuale. Gratë që morën pjesë në studimin cilësor thanë se nuk do të donin të pranonin se kishin përjetuar dhunë seksuale, pasi ato mund të shiheshin nga të tjerët si të “dëmtuara” dhe se një burrë tjetër nuk mund t’i pranonte ato në të ardhmen për shkak të kësaj.

Disa gra që morën pjesë në studimin cilësor ishin të vetëdijshme se mund të shkonin tek psikologu për këshillim. Megjithatë, disa mendonin se ishte krijuar një lloj stigme lidhur me të shkuarit te psikologu, ndërsa të tjerat ishin të shqetësuara për koston që kishte. Disa gra gjithashtu mendonin se një psikolog me gjasa do t’i këshillonte ato të qëndronin me burrin e tyre dhe që gruaje ta inkurajonte burrin që ai të ndryshonte sjellje.

Disa nga gratë që morën pjesë në studimin cilësor thanë se nuk ishin në dijeni të ndo-një shërbimi të veçantë që do t’u siguronte atyre mbështetje nëse do t’i ishin nënshtruar dhunës. Të vetmet shërbime që ato mendonin se mund të aksesonin ishin policia dhe shërbimet shëndetësore. Kjo bie disi në kundërshti me 70% të grave të cilat thonë se janë të informuara se çfarë duhet të bëjnë nëse përjetojnë dhunë.

Gratë rrome që morën pjesë në studimin cilësor mendonin se do të injoroheshin nga policia nëse do raportonin dhunën e shkaktuar nga partneri intim. Ato shprehën besimin se qëndrimi i komunitetit në të cilin ato jetonin ishte se dhuna është normale dhe pjesë e stilit të tyre të jetesës. Ato thanë se do të hezitonin shumë para se t’i drejtoheshin ndonjë institucioni apo të mbështeteshin tek familja e tyre për ndihmë. Ato thanë se familja e lindjes së një gruaje do të përpiqej t’i ndihmonte duke ndërhyrë në emër të tyre dhe duke biseduar me bashkëshortin e gruas dhe familjen e tij.

“Është mëse normale të ndani [eksperiencat tuaja] me familjen...Në rastin e familjeve rome, është paksa turp nëse këto fjalë dalin jashtë familjes, kur komshinjtë dëgjojnë të flitet [për atë]...ky është problem.”

Grua, moshë 19-40, Rome

Shumë nga gratë që morën pjesë në studimin cilësor ishin të pasigurta për llojin e trajtimit që ato do të merrnin nga shërbimet shëndetësore. Ato shprehën bindjen se nëse nuk kanë shumë para ose janë nga grupe të caktuara minoritare, atëherë ato do të trajtohen ndryshe nga personeli mjekësor. Disa gra thanë gjithashtu se nëse i tregonin mjekut të vërtetën se çfarë i kishte shkaktuar plagët, mjeku do ta raportonte incidentin në polici, donin apo nuk donin gratë.

“Sot nuk është nevoja që të jesh rome. Le të marrim shembullin e dy grave, njëra e cila është anëtare e parlamentit ose drejtoreshë e ndonjë insitucioni dhe një që është në pension, e cila ka qënë një punëtoare e ndershme. Atëherë, cila mendon ti se do merrte shërbim më të mirë? E para, sigurisht. Ata nuk do t'i kushtonin fare rëndësi punëtore, edhe pse kjo e fundit mund të ishte një grua mjaft e mirë. Drejtoreshës i duhet thjesht të bëjë një prezantim duke thënë se ajo është drejtoreshë.”

Grua, 56+ vjeç, rurale

Gratë që u intervistuan më gjatë thanë se ato do të hezitonin ta raportnin dhunën nga frika se ajo mund të përshkallëzohej më tej. Ato ishin të shqetësuara se nëse burri i tyre do ta kuptonte se ato e kishin denoncuar atë, atëherë ai do t'i vriste. Në një rast, një grua, burri i së cilës ishte në burg, e kishte kërcënuar se do ta vriste kur ai të lirohej.

“Që kur im shoq është futur në burg, jam ndjerë shumë e qetë. Shkoj në punë dhe kur kthehem në shtëpi, dal me fëmijët e mi për një apo dy orë. Githsesi, ndonjëherë, ndihem e kërcënuar sa herë im shoq më telefon nga burgu. Një herë, më tha: “Shijoje jetën sa të mundesh, se do e shohësh kur të dal unë” ai vazhdon t'u thotë fëmijëve që të më bindin mua që të mos divorcohem sepse ai nuk mund të jetojë dot pa familjen e tij.”

Grua, e mbijetuar e dhunës, moshë 19-40 vjeç

Rast studimor: Historia e R-së

R u njoh me të dashurin e saj në moshën 13 vjeçare dhe në moshën 15 vjeçare, e detyruar nga e ëma u martua me të.

Bashkëshorti i R-së ka ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike mbi atë prej vitesh. E ka rrahur, shkelmuar, qëlluar me thikë dhe fikte cigaren tek ajo. Ai gjithashtu ka ushtruar dhunë seksuale mbi të, madje e deyronte të bënte seks kundër dëshirës së saj.

Bashkëshorti nuk e lejonte të dilte nga shtëpia. Më vonë ai filloi ta kyçte atë brenda në dhomën e gjumit dhe nuk e lejonte as të lahej apo të përdore tualetin.

Arsyeja kryesore pse R-ja nuk e raportonte dhunën ishte frika që kishte nga bashkëshorti dhe asaj që ai mund t'i bënte. Ajo i tregoi nënës së saj, e cila i tha se ai kishte qënë zgjedhja e saj dhe tani ajo duhej ta duronte.

Ajo i tregoi policisë, por ato e liruan bashkëshortin e saj pasi ai premtoi se nuk do ta lëndonte më. Për një muaj ai nuk e lëndoi, por më pas dhuna filloi sërish.

Më në fund, pasi kish duruar për më shumë se 20 vjet vetëm dhunë dhe si pasojë e një sulmi fizik shumë të rëndë, fëmijët e R-së i thanë se duhet të divorcohej nga babai i tyre. Kësaj rrugë, kur ajo e denoncoi dhunën në polici, ato e ndihmuan duke e referuar tek një organizatë që siguronte ndihmë ligjore falas, e cila e ndihmoi të divorcohej. Kjo organizatë bëri të mundur që R-ja të fillonte një kurs e të gjente më pas një punë.

R-ja jeton akoma me ish bashkëshortin e saj, duke qënë se ajo nuk mund ta përballojë të jetojë diku tjetër. Ndaj saj ai ushtron ende dhunë verbale, por jo më dhunë fizike.

Raportimi i ngacmimit seksual

Gjysma e grave të anketuara nuk kanë biseduar me njeri rreth incidentit më serioz të ngacmimit seksual që kanë përjetuar (53%). Pjesa më e madhe e tyre thanë se kishin qënë në gjendje të merreshin vetë me të (65%) ose ngacmimi ka qënë i pakonsiderueshëm dhe se asnjëherë nuk u kishte shkuar në mendje ta raportonin (43%). Një pakicë citoi turpin ose ndjesinë e sikletit (3%) ose thanë se donin ta mbanin ndodhinë private ose kishte dhe nga ato që mendonin se raportimi nuk do t'u vinte hiç në ndihmë (të dyja 4%).

Ndërkohë ato që folën mbi incidentin e tyre më serioz të ngacmimit seksual, e bënë këtë gjë më së shumti me anëtarë të familjes ose me një të afërm (24%), një mik (23%) ose një partner (7%). Vetëm 1% kanë kontaktuar policinë, dhe asnjëra prej grave të anketuara nuk ka kontaktuar me ndonjë organizatë për mbrojtjen e të mbijetuarave të dhunës.

6.4 Kënaqësia me shërbimet

Gratë që morën pjesë në studimin cilësor të cilat kishin raportuar dhunë në polici, kishin eksperiencë të ndryshme. Në një rast, një grua tregoi se kishte shumë pak pritshmëri nga policia, ndërkohë që i rezultoi e kundërta, policia u tregua shumë mbështetëse. Gruaja ishte dhunuar brutalisht fizikisht, e raportoi dhunën në polici, shpjegoi se policia kishte qenë e kuptueshme, aspak paragjyquese dhe e informuan atë mbi shërbimet që siguronin ndihmë ligjore dhe mbështetje psikologjike falas.

Sidoqoftë, të mbijetuarat e tjera të dhunës së shkaktuar nga parteri intim kishin përvoja jo fort pozitive me raportimin e dhunës në polici. Një grua nga një grup etnik minoritar, dhunohet psikologjikisht dhe fizikisht nga bashkëshorti i saj. Pas një sulmi fizik veçanërisht të rëndë, ajo shkoi për të marrë kujdes mjekësor dhe mjeku ia raportoi dhunën policisë. Policia i tha gruas se nuk do të nisin ta kërkonin burrin e saj, ajo duhej t'i telefononte ata kur ai të kthehej në shtëpi. Policia më vonë e arrestoi, por e detyroi gruan që të shkonte në rajonin e policisë. Ata pastaj e shtynin gruan që të hiqte dorë nga akuzat, megjithëse ajo kishte kërkuar vetëm që policia t'i jepte një paralajmërim burrit të saj. Ajo mendonte se sjellja e punonjësve të policisë ndaj saj ishte diskriminuese për shkak të përkatësisë etnike që ajo kishte.

“Kur unë e raportova dhunën në polici, ata më thanë se nuk mund të dilnin të kërkonin e të arrestonin burrin tim, por që duhej unë t'i lajmëroja ata kur të vinte ai në shtëpi. Edhe pse isha e frikësuar, u ktheva dhe e njoftova policinë kur burri u khye. Policia erdhi në shtëpi dhe e arrestoi burrin tim, por më kërkuan edhe mua që të shkoja në rajon me ta. Në rajonin e policisë unë pashë diskriminim ndaj meje si pasojë e etnisë sime. Gjithashtu, edhe pse unë i kërkova policisë që të mos e arrestonte tim shoq, por t'i jepte vetëm një paralajmërim që mos përsëriste të njëjtën sjellje, disa policë më këshilluan në mënyrë agresive që unë t'i tërhiqja akuzat”.

Grua, e mbijetuar e dhunës, moshë 19-40

Shumë pak gra që morën pjesë në studimin sasior kishin kontaktuar policinë ose shërbimet e tjera përkatëse, por në total, nga ato që kishin raportuar, shumica kishte mbetur e kënaqur me ndihmën ose këshillat që morën.

6. Impakti i dhunës në jetët e grave dhe barrierat e të kërkuarit ndihmë



7. Përjetimi i dhunës nga grupe të veçanta të grave

Anketa mblodhi një mori hollësish nga të anketuarat, të cilat mundësojnë një analizë më të thellë për shkallën e përhapjes së dhunës në grupe të ndryshme të grave. Qëllimi është përcaktimi i përhapjes dhe rrezikut të dhunimit që mund të përjetojnë grupe të caktuara. Ky kapitull përqendrohet në dallimet domethënëse të përjetimit të të gjitha formave të dhunës, përfshirë ngacmimet seksuale, nga grupe të ndryshme të grave.

Mosha

Sic përshkruhet në Kapitullin 2, mosha është një faktor i rëndësishëm në dallimet që vërehen në qëndrimet ndaj grave dhe dhunës. Mosha, gjithashtu, është faktor në përhapjen e dhunës në grupmosha të ndryshme, ndër të cilat gratë në moshë të re pohojnë se kanë përjetuar shumë nga format e dhunës. Gratë 18 deri në 29 vjeç kanë më shumë gjasa të deklarojnë se i janë nënshtruar një forme të dhunës nga partneri intim (72% në krahasim me mesataren prej 63%) se ato të moshës 30-39 vjeç (68%), ndërsa gratë mbi 60 vjeç kanë më pak gjasa ta pohojnë këtë (55%). Gratë më të reja kanë më shumë gjasa të pohojnë se kanë qenë objekt i dhunës psikologjike nga një partner i mëparshëm (68% e 18 – 29-vjeçareve në krahasim me 53% në përgjithësi).

Gjithashtu, gratë e grupmoshës 18-29 vjeç janë më të prirura të pohojnë se kanë përjetuar dhunë fizike nga partneri aktual në 12 muajt përpara anketës (10%) krahasuar me gratë mbi 60 vjeç (4%). Gratë e grupmoshës 18-29 vjeç, po ashtu, kanë më shumë gjasa të pohojnë se janë dhunuar nga individë të tjerë jo partnerë në 12 muajt përpara anketës (5% në krahasim me 2% në përgjithësi). Gratë e grupmoshës 30-39 vjeç kanë më shumë gjasa të thonë se janë dhunuar fizikisht nga individë jo-partnerë që në moshën 15 vjeçare (15%), kurse gratë mbi 60 vjeç janë më pak të prirura ta pohojnë këtë (6%).

Sa i përket dhunës në fëmijëri, gratë e moshës 40-49 vjeç kanë më pak gjasa të thonë se i janë nënshtruar dhunës fizike (20% kundrejt 26% në përgjithësi). Gratë midis 30 dhe 39 vjeç kanë më shumë gjasa të pohojnë se në fëmijëri kanë qenë objekt i dhunës psikologjike (7% në krahasim me 4% në përgjithësi).

Përqindjet e pohimeve për ngacmimet seksuale ndjekin qartazi kufijtë moshorë. Pesëdhjetë e katër përqind e 18-29 vjeçareve deklarojnë se kanë qenë objekt i ngacmimeve seksuale, krahasuar me 27% të 40 – 49-vjeçareve, 25% të 50 – 59-vjeçareve dhe 18% e grave 60 vjeç e sipër. Dy grupet e fundit kanë më pak gjasa të thonë se kjo ka ndodhur në 12 muajt përpara anketës (9% dhe 5% përkatësisht), ndërsa 18 - 29-vjeçaret përsëri kanë më shumë gjasa ta pohojnë këtë (34%). Të njëjtat sjellje vërehen edhe në rastin e formave më të rënda të ngacmimit seksual.

Panorama është e ngjashme edhe në rastin e përndjekjes, me 22% të 18 - 29-vjeçareve që thonë se kanë qenë objekt i saj, në krahasim me 8% të 40-49 vjeçareve dhe 9% të 50-59 vjeçareve dhe grave mbi 60 vjeç. Nëntë përqind e 18 – 29-vjeçareve pohojnë se janë përndjekur 12 muajt përpara anketës, në krahasim me 3% të 40 – 49-vjeçareve dhe 1% të 50 – 59-vjeçareve dhe grave 60 vjeç e sipër.

Forma e marrëdhënies

Të dhënat janë analizuar për të përcaktuar nëse secila nga të anketuarat kishte pasur një partner në momentin e anketimit (aktualisht ishte e martuar, jetonte me të pa u martuar, ose kishte një marrëdhënie pa bashkëjetesë), kishte pasur një partner të mëparshëm (kishte qenë e martuar më parë, jetonte me një partner pa u martuar, ose kishte një marrëdhënie pa bashkëjetesë), ose nuk kishte pasur partner asnjëherë.

Gratë me partnerë të mëparshëm pa dallim kanë më shumë gjasa të thonë se kanë përjetuar dhunë. Këto gra janë thuajse dy herë më të prirura të pohojnë se kanë qenë pre e dhunës fizike nga individ i jo partner (17% në krahasim me gratë pa partner të mëparshëm (9%).⁷¹ Gjithashtu, ato kanë më shumë gjasa të pohojnë përjetimin e të gjitha formave të dhunës nga partneri aktual.

Gratë me partnerë të mëparshëm kanë më shumë gjasa të deklarojnë se kanë përjetuar ngacmime seksuale (43% kundrejt 31% të grave pa një partner të mëparshëm) dhe se ngacmime seksuale kanë përjetuar edhe në 12 muajt përpara anketës (26% kundrejt 15%). Ato gjithashtu kanë më shumë gjasa të jenë përndjekur në një periudhë të jetës (20% kundrejt 12%). Përveç kësaj, 8% e grave me një partner të mëparshëm deklarojnë se kanë përjetuar dhunë psikologjike si fëmijë, krahasuar me 3% të grave pa partnerë të mëparshëm.

Punësimi dhe profesioni

Lidhje ka edhe midis përhapjes së dhunës dhe punësimit e profesionit të viktimës, të cilat, gjithashtu, mund të jenë të lidhura me moshën.

Për shembull, përqindja e studenteve që pohojnë se kanë përjetuar ngacmime seksuale që nga moshë 15 vjeçare (62% kundrejt 34%), si edhe në 12 muajt përpara anketës (42% kundrejt 17%) është më e lartë se sa mesatarja. Kjo përqindje është më e lartë edhe se ajo e 18 – 29-vjeçarëve, grupmosha ku bëjnë pjesë thuajse të gjithë studentet.

Studentet gjithashtu kanë më shumë gjasa të pohojnë dhunën në fëmijëri (36% në krahasim me 27% në tërësi dhe 31% të 18 - 29-vjeçarëve) dhe se janë përndjekur që në moshën 15 vjeçare (28% në krahasim me 13% mesatarisht dhe 22% e 18 – 29-vjeçarëve).

Gratë në punë të paguara, gjithashtu, kanë më shumë gjasa të thonë se kanë përjetuar ngacmime seksuale që në moshën 15 vjeçare (40%) ose në 12 muajt përpara anketës (21%). Në anën tjetër, gratë që janë në pension kanë më pak gjasa të thonë se kanë qenë objekt i ngacmimeve seksuale që në moshën 15 vjeçare (17%) ose në 12 muajt para anketës (4%). Po ashtu, gratë në pension kanë më pak gjasa të pohojnë dhunën fizike nga një partner i mëparshëm (9% në krahasim me 22% në përgjithësi). Nxënëset (17%) kanë më shumë gjasa të pohojnë dhunën fizike në një periudhë të caktuar nga një individ jo-partner se sa gratë në pension (6%).

Gratë që kanë veprimtari kryesore detyrat dhe përgjegjësinë e kujdesit për anëtarët e familjes, kanë më shumë gjasa se të tjerat të pohojnë se kanë përjetuar disa forma dhune. Përqindja është më e lartë në rastin e dhunës psikologjike nga partneri aktual (70% në krahasim me 61% në përgjithësi) dhe në rastin e dhunës fizike në fëmijëri (41% krahasuar me 26% në përgjithësi). Në anën tjetër, këto gra kanë më pak gjasa të thonë se kanë përjetuar ngacmime seksuale që në moshën 15 vjeçare (24% kundrejt 34%) ose në 12 muajt përpara anketës (8% kundrejt 17%). Ato, gjithashtu, kanë më pak gjasa të pohojnë se kanë përjetuar format më të rënda të ngacmimeve seksuale.

Gratë në profesione të kualifikuara janë më shumë se dy herë më të gatshme se gratë në profesione të thjeshta të pohojnë se kanë përjetuar ngacmime seksuale që në moshën 15 vjeçare (63% kundrejt 31%) ose në 12 muajt para anketës (42% kundrejt 15%). E njëjta përqindje ndeshet edhe në format më të rënda të ngacmimit seksual. Gratë në profesione të kualifikuara, gjithashtu, kanë më shumë gjasa të pohojnë se janë përndjekur (32%) se mesatarja (13%).

71 Për dhunën psikologjike, shifra është 73% në krahasim me 60% të grave pa partnerë të mëparshëm; për dhunën fizike, përqindjet e raportuara janë më të larta si për periudhat më të hershme të jetës (24% kundrejt 16%) ashtu edhe për 12 muajt përpara anketës (12% kundrejt 7%). Shifrat vlejné edhe për rastet e dhunës seksuale për periudha më të hershme të jetës (6% kundrejt 2%) ashtu edhe në 12 muajt përpara anketës (4% kundrejt 1%).

Arsimi

Anketa përmbante edhe një pyetje lidhur me nivelin më të lartë të arsimit që gratë kishin përfunduar: arsimin nëntë vjeçar, të mesëm ose të lartë. Siç është theksuar më parë, ka një korrelacion midis nivelit të arsimimit të gruas dhe llojeve të dhunës që ajo ka përjetuar.

Gratë me arsim nëntë vjeçar kanë më shumë gjasa të thonë se kanë përjetuar dhunë fizike nga partneri aktual në një periudhë të jetës (22% kundrejt 17% në përgjithësi) ose në 12 muajt përpara anketës (11% kundrejt 7% në përgjithësi). Ato, gjithashtu, kanë më shumë gjasa të thonë se kanë qenë objekt i dhunës seksuale nga një partner i tanishëm në një periudhë të jetës (5% në krahasim me mesataren prej 3%).

Megjithatë, gratë që kishin kryer sado pak arsim të lartë, janë mbi tre herë më të prirura se gratë vetëm me arsim nëntë vjeçar, të pohojnë përjetimin e ngacmimeve seksuale që në moshën 15 vjeçare (60% kundrejt 18%) dhe thajse pesë herë më shumë të prirura të pohojnë ngacmimin seksual 12 muaj përpara anketës (34% kundrejt 7%). Të njëjtat përqindje ndeshen edhe në rastet e formave më të rënda të ngacmimit seksual. Gjendja është e ngjashme edhe kur bëhet fjalë për përndjekjen, të cilën 24% e grave me njëfarë arsimit të lartë thonë se e kanë përjetuar që në moshën 15 vjeçare, krahasuar me 6% të grave vetëm me arsim nëntë vjeçar. Kur bëhet fjalë për 12 muajt përpara anketës, gratë me njëfarë arsimit të lartë janë katër herë më shumë të prirura të pohojnë se janë përndjekur (8% kundrejt 2% të grave vetëm me arsim nëntë vjeçar).

Të ardhurat

Gratë që morën pjesë në anketim, bazuar në deklaratimet e tyre, u ndanë në katër grupe: ato që jetonin në mënyrë të kënaqshme me të ardhurat e tyre të tanishme, ato që ia dilnin, ato me vështirësi dhe ato me shumë vështirësi. Ekzistojnë prova se gratë në dy kategoritë e fundit kanë më shumë gjasa të kenë përjetuar dhunë në një moment të jetës së tyre.

Gratë që jetojnë me vështirësi me të ardhurat e tyre të tanishme kanë më shumë gjasa të thonë se kanë qenë objekt i dhunës psikologjike nga partneri i tyre aktual (71% në krahasim me 61% në përgjithësi). Gratë që jetojnë me shumë vështirësi kanë më shumë gjasa të thonë se në jetën e tyre kanë përjetuar dhunë fizike nga partneri aktual (25% në krahasim me 18% në përgjithësi dhe 14% të atyre që jetojnë në mënyrë të kënaqshme).

Gratë që jetojnë me vështirësi ose me shumë vështirësi me të ardhurat e tyre aktuale, kanë më shumë gjasa të thonë se në fëmijërinë e tyre kanë përjetuar dhunë fizike (31% dhe 32% përkatësisht kundrejt 17% të grave që jetojnë kënaqshëm). Gratë që e kanë jetën shumë të vështirë kanë më shumë gjasa të thonë se në fëmijërinë e tyre kanë përjetuar edhe dhunë psikologjike (7% në krahasim me 4% në përgjithësi).

Grupet minoritare

Brenda kampionit me 1,858 gra, 296 prej tyre e shihnin veten pjesëtare të një apo më shumë pakicave në komunitetet ku jetonin. Këtu përfshihen: një pakicë etnike (194), një pakicë emigrantësh (9), një pakicë fetare (nëntë), një pakicë personash me aftësi të kufizuara (3), refugjatë/persona të zhvendosur (17) dhe persona të riatdhesuar/ish të zhvendosur/refugjatë (7), si dhe 24 gra që deklarorin se bënë pjesë në disa pakica të tjera të papërcaktuara. Për shkak të përqindjeve të vogla, studimi trajton vetëm dallimet midis pakicave etnike dhe popullsisë së përgjithshme.

Gratë e pakicës etnike janë thajse dy herë më shumë të prirura të pohojnë dhunën fizike që në moshën 15 vjeçare nga një individ jo partner, (21% në krahasim me 11% në përgjithësi) ose nga një partner i mëparshëm (47% në krahasim me 22% në përgjithësi). Po ashtu, ato janë më të prirura të thonë se kanë përjetuar dhunë fizike nga partneri i tanishëm në 12 muajt përpara anketës (13% në krahasim me 7% në përgjithësi).

Gjithashtu, ato kanë më shumë gjasa të pranojnë se i janë nënshtruar dhunës psikologjike në fëmijëri (9% në krahasim me 4% në përgjithësi).

Gratë pa fëmijë

Gratë pa fëmijë kanë më shumë gjasa të thonë se janë përballur me dhunën. Kjo mund të jetë e lidhur me moshën, po të mbahet parasysh përqindja më e lartë e grave në moshë të re që pranojnë dhunën dhe fakti që këto gra kanë më shumë gjasa të kenë pasur apo të kenë fëmijë.

Gratë pa fëmijë janë më të prirura të pohojnë dhunën fizike nga individ i jo partner (14% në krahasim me 10% të atyre që kanë ose kanë pasur fëmijë) dhe në 12 muajt përpara anketimit (5% kundrejt 2%). Ato kanë më shumë gjasa të pranojnë se kanë qenë objekt i dhunës psikologjike nga një partner i mëparshëm (70% kundrejt 46%).

Ngacmimet seksuale janë përjetuar më shumë nga gratë pa fëmijë, që në moshën 15 vjeçare (57% kundrejt 26% grave me fëmijë) si dhe në 12 muajt përpara anketimit (37% kundrejt 11%). Të njëjtat përqindje ndeshen edhe në format më të rënda të ngacmimit seksual. Gratë pa fëmijë kanë më shumë gjasa të pranojnë se kanë qenë objekt i përndjekjes që në moshën 15 vjeçare (26% kundrejt 9%) si dhe në 12 muajt përpara anketës (11% kundrejt 2%). Gjithashtu, ka më shumë të ngjarë që ato të pohojnë se janë përballur me dhunën që në fëmijëri (32% kundrejt 26%).

Vendndodhja

Gratë që jetojnë në veri të Shqipërisë janë gjithnjë e më shumë të prirura të thonë se kanë përjetuar dhunë:

- Njëzet e tre përqind tregojnë se kanë përjetuar dhunë fizike nga partnerët e tanishëm në krahasim me 17% të totalit. Për 12 muajt para anketimit të dhënave janë përkatësisht 15% dhe 7%.
- Gratë nga veriu kanë më shumë gjasa se gratë nga rajonet qendrore të thonë se kanë përjetuar dhunë seksuale nga partneri i tanishëm në një moment të caktuar (4% përkundrejt 3%)
- Ato gjithashtu kanë më shumë gjasa të thonë se kanë përjetuar dhunë psikologjike në fëmijëri (6% në krahasim me 3% në rajonet qendrore dhe jugore).

Gratë në rajonin qendror kanë më shumë gjasa se gratë nga rajoni jugor të raportojnë se kanë përjetuar ngacmime seksuale që nga moshën 15 vjeçare (43% kundrejt 23%) ose 12 muajt para sondazhit (26% kundrejt 7%). Ky model vlen edhe për format më të rënda të ngacmimeve seksuale. E njëjta pamje shihet edhe në lidhje me përndjekjen, ku 18% e grave nga rajoni qendror tregojnë se kanë përjetuar ngacmim seksual që nga moshën 15 vjeçare, krahasuar me 9% të grave nga jugu. Sa i përket përndjekjes në 12 muajt para anketës, ndikimi është 7% nga gratë e rajoneve qendrore në krahasim me 2% të grave nga jugu.

Gratë që jetojnë në zonat urbane janë dyfish më të prirura të kenë përjetuar ngacmim seksual në 12 muajt para anketës krahasuar me ato që jetojnë në zonat rurale

Table 7.1: : Prevalenca e dhunës, sipas rajonit

	Veri %	Qendër %	Jug %
Ngacmim seksual – Që në moshën 15 vjeç	31	43	23
Ngacmim seksual- Në 12 muajt para studimit	15	26	7
Përndjekja- Që në moshën 15 vjeç	11	18	9
Përndjekja- Që në moshën 15 vjeç	11	18	9
Përndjekja- Në 12 muajt para studimit	3	7	2
Dhunë në fëmijëri (të gjitha format)	25	30	26
Dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jo partneri Që në moshën 15 vjeç	12	12	10
Dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jo partneri- Në 12 muajt para studimit	4	2	2
Dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim - Që në moshën 15 vjeç	24	18	18
Dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim - Në 12 muajt para studimit	14	4	6
Dhunë psikologjike nga jo partneri - Që në moshën 15 vjeç	64	61	61
Dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri ose jo partneri - Që në moshën 15 vjeç	22	22	21
Dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri ose jo partneri - Në 12 muajt para studimit	12	5	7

BAZA: Gratë në Shqipëri nga moshë 18–74 (1,858); të gjitha gra me partner (1,660)

BURIMI: OSBE-ka bërë një studim mbi dhunën ndaj grave (2018)

Gratë që jetojnë në zonat urbane kanë më shumë gjasa të thonë se kanë përjetuar ngacmime seksuale që nga moshë 15 vjeçare (40% në krahasim me 25% të grave që jetojnë në zonat rurale) dhe në 12 muajt para anketimit (21% kundrejt 12%). Kjo vlen edhe për format më të rënda të ngacmimit seksual.

Karakteristikat e partnerit aktual

U mblodh informacion mbi moshën, arsimin, punësimin dhe përvojat dhe sjelljet e caktuara të partnerëve të anketuarave.

Megjithëse madhësia e bazës është e vogël, gjetjet sugjerojnë që të kesh një partner që pi për t'u dehur të paktën një herë në javë rrit rrezikun e dhunës. Mbi nëntë në dhjetë gra me një partner të tillë tregojnë se ato i janë nënshtruar dhunës psikologjike nga ana e tyre, ndërsa më shumë se gjysma thonë se i janë nënshtruar dhunës fizike deri në një pikë dhe tre në dhjetë thonë se kjo ka ndodhur në 12 muajt e para anketimit.

Gratë, partnerët e të cilave kërkonin që ata të martoheshin me ta, kanë më shumë gjasa të thonë se kanë qenë subjekt i dhunës psikologjike nga partneri i tyre aktual (82% në krahasim me 61% në përgjithësi).



8. Përfundimet dhe Rekomandimet Kryesore

Gjetjet e studimit sasior dhe cilësor zbulojnë tre përfundime⁷² kryesore mbi dhunën ndaj grave në Shqipëri:

1. Normat dhe qëndrimet kulturore në Shqipëri ndihmojnë në ruajtjen e një situatë ku pritshmëria është që gratë t'i binden burrave dhe ku dhuna seksuale në marrëdhëniet intime pranohet gjerësisht

Dyzet e shtatë përqind e grave në Shqipëri besojnë se shumica e miqve të tyre do të pajtohen me idenë se “një grua e mirë duhet t'i bindet bashkëshortit të saj edhe nëse nuk është dakord me të”. Nëntëmbëdhjetë përqind besojnë se marrëdhëniet seksuale pa pëlqim janë të justifikuar në një martesë ose ndërmjet partnerëve që jetojnë së bashku. Ndërsa 4% e grave tregojnë se kanë përjetuar dhunë seksuale nga partnerët e tyre të tanishëm ose të mëparshëm që nga moshën 15 vjeçare. Gratë në studimin cilësor mendonin se dhuna seksuale brenda marrëdhënieve intime ishte shumë e zakonshme, por nuk u diskutua. Ato shprehën mendimin se është gjerësisht e pranuar se një grua duhet t'i nënshtrohet bashkëshortit të saj dhe se nuk kishte asnjë lloj përdhunimi martesor. Gratë që pajtohen se dhuna në familje është një çështje private kanë më shumë gjasa të thonë se kanë përjetuar dhunë nga partneri sesa ato që nuk pajtohen (23% kundrejt 16%). Për më tepër, gratë të cilat pajtohen se është detyrim i gruas të ketë marrëdhënie seksuale me burrin gjithashtu kanë më shumë gjasa të thonë se kanë përjetuar dhunë intime nga partneri (25% kundrejt 18% të atyre që nuk pajtohen). Këto norma dhe qëndrime janë të dëmshme për gratë dhe paraqesin pengesë për arritjen e plotë të barazisë gjinore dhe lirisë nga të gjitha format e DHnG. Komiteti CEDAW rekomandoi që qeveria shqiptare të trajtojë stereotipet gjinore që mundësojnë më tej diskriminim ndaj grave duke zhvilluar një strategji të gjerë në të gjithë sektorët për të eliminuar stereotipet diskriminuese. GREVIO gjithashtu rekomandoi përdorimin e një qasjeje të qartë gjinore për adresimin e DHnG.

2. Dhuna ndaj grave nuk raportohet aq sa duhet, dhe gratë nuk po përdorin shërbime ose nuk po merren në mbrojtje

Shumica e grave që morën pjesë në studim thonë se nuk kanë kontaktuar policinë edhe pas incidenteve më serioze të dhunës fizike dhe / ose seksuale që kanë përjetuar në lidhje me partnerët e tanishëm (97%) dhe partnerët e mëparshëm (84%). Kjo mund të lidhet me besimin që ka 48% e grave, se dhuna në familje është “çështje private” që duhet të mbahet brenda familjes dhe se 41% besojnë se gratë që thonë se janë abuzuar shpesh shpikin apo ekzagjerojnë pretendimet e abuzimit apo përdhunimit.

Procesi gjyqësor gjithashtu e vë barrën e provës mbi të mbijetuarat, në krahasim me autorin. Kjo barrë prove mund të ndihmojë të shpjegojë se pse shumica e grave do të diskutonin vetëm incidentet e dhunës me familjen dhe miqtë, në vend që të kërkonin mbështetje nga autoritetet e duhura. Në studimin cilësor, gratë thanë se, përveç turpësorisë dhe frikës se çfarë do të mendonin për to familjet dhe shoqëria e tyre, ato gjithashtu hezitonin të raportonin dhunën sepse kishin frikë se dhuna do të përshkallëzohej. Ato thanë se nuk kishin besim në institucionet gjyqësore të vendit, nga frika se nuk do të merrnin seriozisht ankesat e tyre dhe do të dështonin t'i mbronin ato dhe nuk ishin në dijeni të shërbimeve që mund t'i ndihmonin. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë për gratë nga zonat rurale dhe grupet minoritare. Ekspertët që morën pjesë në studimin cilësor shprehën besimin se disa nga këto gra nuk ishin në gjendje të siguronin informacion rreth shërbimeve përkatëse dhe se gratë nga këto grupe minoritare do të mund të përballëshin me diskriminim gjatë qasjes në shërbime. Kjo u dëshmuar nga përvojat dhe pritshmëritë e grave Rome që morën pjesë në studimin cilësor, të cilat mendonin se aktorë si policia do të mendonin se dhuna është pjesë e kulturës së komunitetit të tyre dhe nuk do t'i merrnin seriozisht pretendimet e tyre.

72 Këto përfundime janë në përputhje me rekomandimet e publikuara nga CEDAW dhe GREVIO.

Disa ekspertë argumentuan se aksesit në shërbimet shumë-sektoriale do të ishte një nga mënyrat më të mira për të mbështetur gratë. Ata thanë se ky sistem mund të shihej si një sukses, sepse rezultoi në një rritje të numrit të grave që iu ofruan shërbime në një periudhë të shkurtër kohore. Përveç kësaj, sipas ekspertëve, ofrimi i ndihmës juridike falas nuk është zbatuar siç duhet. Ata thanë se mbështetja aktualisht ofrohet vetëm nga OJQ-të dhe se gjykatat nuk po përmbushnin detyrimet e tyre në këtë drejtim. Në Shqipëri, është krijuar një mekanizëm referimi kombëtar që t'u mundësojë viktimave të dhunës qasje në shërbimet e ndryshme mbështetëse (si ndihma juridike falas, ndihma nga një psikolog i trajnuar, shërbime shëndetësore dhe marrja në mbrojtje). Ekspertët e intervistuar shprehën mendimin se ky ishte një hap në drejtimin e duhur, por më shumë duhet bërë për të siguruar që gratë në të gjitha fushat t'i drejtohen shërbimeve përkatëse dhe që këto të jenë në dispozicion kudo që ato jetojnë.

Në studimin cilësor, gratë që kishin përjetuar dhunë u shprehën se mungesa e qasjes në mjete financiare ishte një nga barrierat kryesore që i pengonte gratë të linin partnerët abuzivë. Edhe në një rast kur gruaja kishte qasje në ndihmë juridike për të marrë një divorc nga një partner abuziv, ajo ende duhet të qëndronte në shtëpi me ish-partnerin e saj abuziv pasi nuk mund të përballonte jetesën askund tjetër.

GREVIO rekomandoi që Shqipëria të sigurojë fonde të qëndrueshme dhe të vazhdueshme për OJQ-të e grave që punojnë për të mbështetur viktimat dhe për të parandaluar dhunën, si dhe të mbajnë parimin e përgjegjësisë civile të zyrtarëve publikë të cilët nuk përmbushin detyrën e tyre në marrjen e masave të nevojshme parandaluese ose mbrojtëse. CEDAW rekomandoi që shteti të marrë masa për të inkurajuar gratë që të raportojnë rastet e dhunës me bazë gjinore duke ofruar ndihmë juridike falas, përfshirë në zonat rurale dhe të largëta; të rrisë numrin dhe kapacitetin e strehave shtetërore; të rrisë financimin e strehave të drejtuar nga organizatat joqeveritare; dhe të krijojnë mekanizma për kontraktimin, delegimin ose marrjen e shërbimeve të organizatave joqeveritare në mënyrë që t'u përgjigjet nevojave të të gjitha grave që janë viktime të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë gratë romë dhe egjiptiane, gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë që jetojnë në zonat rurale dhe të largëta.

Shumica e grave që morën pjesë në studim thonë se nuk kanë kontaktuar policinë edhe pas incidenteve më serioze të dhunës fizike dhe / ose seksuale që kanë përjetuar nga partnerët e tanishëm dhe partnerët e mëparshëm

3. Ka mangësi në legjislacion, zbatimin e ligjeve dhe grumbullimin e të dhënave

Siç është përmendur në Kapitullin 2, ka pasur një numër ndryshimesh të fundit të legjislacionit dhe politikave në Shqipëri, përfshirë ndryshimet në Kodin Penal, përmirësimet në procesin e marrjes së urdhrave të mbrojtjes dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për ata njerëz me vështirësi ekonomike. Ekspertët e intervistuar shprehën shpresën se nëse këto ndryshime do të zbatoheshin siç duhet, kjo do të bënte dallim për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore (DHBGJ). Megjithatë, ende ekzistojnë boshllëqe, të tilla si fakti që përkufizimi i përdhunimit në Kodin Penal, ku përdorimi i forcës ose kërcënimi i forcës kërkohet për të vërtetuar dhunimin, nuk është në linjë me Konventën e Stambollit. Si ekspertët ashtu edhe të mbijetuarat e dhunës shprehën besimin se ishte e rëndësishme për të përmirësuar normat e ndjekjes penale të autorëve dhe për të zbatuar dënime më të ashpra për dhunën ndaj grave si një mënyrë efektive për të reduktuar DHBGJ dhe për të inkurajuar të mbijetuarit të raportojnë dhunën. Ata gjithashtu shprehën mendimin se autorëve duhet t'i kërkohet të marrin këshillime për të zvogëluar gjasat e recidivizmit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, filloi mbledhjen e të dhënave për dhunën në familje në vitin 2014 përmes një sistemi online. Megjithatë, ekspertët e intervistuar kanë bërë thirrje për përmirësimin e këtij sistemi për të siguruar qëndrueshmëri në të gjithë Shqipërinë. Ata gjithashtu shprehën besimin se do të ishte e dobishme nëse të dhënat hidhen nga të gjitha shërbimet e përfshira (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, policia dhe sistemi i drejtësisë) në mënyrë që të jetë e mundur një analizë e plotë e qasjes ndaj shërbimeve dhe rezultateve për të mbijetuarit.

GREVIO rekomandoi që Shqipëria të ndryshojë legjislacionin e saj penal për ta bërë vepër penale dhunën seksuale në mungesë të pëlqimit të dhënë lirisht dhe në përputhje me standartet e Konventës në lidhje me ndjekjen ex parte dhe ex officio, ndërsa GREVIO dhe CEDAW rekomanduan që shteti të forcojë zbatimin e vendimeve të gjykatës, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me urdhrat e mbrojtjes ose urdhrat për mbrojtje emergjente për gratë që i kanë mbijetuar dhunës me bazë gjinore. Përveç kësaj, gjetjet e këtij studimi çojnë në rekomandime më specifike.

Gratë që pajtohen se dhuna në familje është një çështje private ka më shumë gjasa të thonë se kanë përjetuar dhunë nga partneri intim se sa ato që nuk pajtohen me këtë (23% përkundrajt 16%)

Rekomandime

Rekomandimet e mëposhtme bazohen në gjetjet dhe përfundimet e mësipërme nga studimi dhe hulumtimi cilësor dhe një tryezë e rumbullakët me aktorët kryesorë qeveritarë dhe OJQ-të

Për qeverinë:

1. Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për dhunën seksuale, veçanërisht në marrëdhëniet me partnerin intim, në bashkëpunim me OSHC-të e grave.
2. Analiza e shkaqeve dhe pasojave për mos-reagimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse në përputhje me rregullat dhe legjislacionin. Kjo analizë do të shërbejë për të përgatitur rekomandime specifike për përmirësimin e punës së aktorëve dhe institucioneve përgjegjëse.

Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

3. Investimi në ngritjen e strehëzave për rastet urgjente dhe qendrave të tjera për trajtimin e përdhunimit, për luftën kundër stigmës dhe rritjen e nivelit të raportimit të dhunës seksuale, si dhe për të ofruar shërbime të përshtatshme shëndetësore dhe psikologjike për të mbijetuarat e dhunës seksuale.
